



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Gjuhë Angleze”
ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Xhuvani”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Alda Jashari (Cicko)



2. Dr. Valbona Loshi (Softa)

Muaji/Viti

Mars, 2023


RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” ofruar nga Institucioni i
Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Xhuvani”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhëve të Huaja
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Gjuhë Angleze”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 300 date 21.6.1994
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	VENDIM Nr. 414 date 12.11.1991
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr.266, datë 10.08.2009
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Nuk ka
8	Cikli i studimit:	Cikli i I-rë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti akademik 2021-2022 14 PAE; 1 Prof.as.Dr 12 Dr 1 Msc
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2019-2020; 23 studentë Viti akademik 2020-2021; 19 studentë Viti akademik 2021-2022; 18 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi Bachelor në "Gjuhë Angleze" është program i ciklit të parë të studimeve, i cili ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani". Universiteti "Aleksandër Xhuvani" është institucion publik i arsimit të lartë, i cili zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze licensuar fillimisht me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 300 datë 21.06.1994, i emërtuar si dega e Gjuhës Angleze, pjesë përbërëse e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë. Me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr 728, date 19.11.1998, dega Gjuhë Angleze ofrohet nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja. Në kuadër të riorganizimit, me vendim Nr.821, date 04.12.2007, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, tashmë me emërtimin Departamenti i Gjuhëve të Huaja, i bashkohet Fakultetit të Shkencave Humane. Organizimi, ndarja dhe strukturimi i programit të studimit "Bachelor në "Gjuhë Angleze" mbështetet plotësisht në legjislacionin në fuqi, përmbush detyrimet e përcaktuara në Ligjin Nr.80/2015 dhe specifikat e përcaktuara në VKM nr.40/2018 "Për elementët e Programeve të studimit të ofruar nga IAL" dhe Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve. Programi Bachelor në "Gjuhë Angleze" është hartuar dhe ofrohet në përputhje me objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të Universitetit të Elbasanit dhe të njësisë kryesore Fakultetit të Shkencave Humane, duke synuar ti pajisë studentët me formimin e duhur shkencor dhe aftësitë e duhura profesionale, në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. Kohëzgjatja normale e programit të ciklit të parë është tre vite akademike, të ndara në 6 semestra, me nga 15 javë mësimore secila. Kreditet e siguruara përgjatë këtij cikli janë 180, të shpërndarë përkatësisht 60 kredite për vit. Programi i studimit "Bachelor në "Gjuhë Angleze", përmes lëndëve dhe moduleve të ofruara synon t'i pajisë studentët me dijet, njohuritë dhe shprehitë gjuhësore, letrare dhe komunikative bazë, sikurse dhe t'i aftësojë ata në fusha të veçanta si përkthimi dhe interpretimi, komunikimi dhe mësimdhënia, duke ju ofruar mundësi punësimit në një sferë gjerë profesionale dhe specialitetesh. Grupi mësimor i Gjuhës Angleze është strukturë e Departamentit të Gjuhëve të Huaja dhe përbëhet nga një personel prej (14) pedagogësh me kohë të plotë nga të cilët (1) profesor i asociuar, (12) doktorë shkencash dhe (1) Msc. Personeli akademik i DGjH është i angazhuar për zhvillimin dhe rritjen akademike në shërbim të programit të studimit "Bachelor" në "Gjuhë Angleze" nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, botimit të artikujve shkencorë dhe trajnime vendase dhe të huaja.




PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në përputhje me "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit, 2017" ka aplikuar më datë 20.12.2021 nëpërmjet sistemit AMS për nisjen e procedurave për akreditimin e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze". Ky është procesi i parë i vlerësimit të standarteve të cilësisë për këtë program studimi nga Agjensia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL).

Në përbërjen e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), të ngritur nga ASCAL, për procesin e vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" u përzgjedhën dy ekspertë: Dr. Valbona Loshi (Softa), pedagoge në Kolegjin Universitar "Wisdom" dhe Dr. Alda Jashari (Cicko), pedagoge në Universitetin "Fan Noli". GVJ u kontaktua në muajin Nëntor 2022 nga përfaqësuesja e ASCAL, Znj.Anilda Beqiraj dhe gjatë takimit të zhvilluar në ambjentet e ASCAL u njoh me procedurën e vlerësimit për shqyrtimin e Dosjes së Vetëvlerësimit, kryerjen e vizitës në institucion dhe përpilimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm. Ekspertëve i'u vu në dispozicion materiali i plotë i depozituar për vlerësim, sipas procedurës së ASCAL dhe pas kohës së nevojshme për procesin e shqyrtimit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacionit shoqërues të tij, nga i cili u përcaktuan edhe pyetjet respektive, u përpilua agjenda e vizitës në Fakultetin e Shkencave Humane, të Universitetit të Elbasanit në datat 5-6 Dhjetor, 2022.

Gjatë vizitës në institucion, në të cilën ishte e pranishme specialistja e ASCAL, Znj.Anilda Beqiraj, Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, i'u vu në dispozicion një sallë, ku u zhvilluan të gjitha takimet e parashikuara sipas agjendës. Në përfundim të këtij procesi, GVJ kërkoi dokumentacion shtesë për diskutimet e ngritura gjatë vizitës, i cili u dorëzua në ASCAL më datë 13.12.2022.

GVJ, pasi rishikoi dokumentacionin e plotë dhe në reflektim të takimeve që pati në institucion, paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas fushave, standarteve dhe kritereve përkatëse, për programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze". Në fund të Raportit të Vlerësimit të Jashtëm, janë përfshirë nëpërmjet një analize SWOT, pikat e forta dhe të dobëta të programit të studimit, si dhe rekomandimet që kanë dalur nga procesi i vlerësimit të jashtëm. Raporti i mëposhtëm është një sintezë e vlerësimit të programit të studimit nga dy ekspertet e vlerësimit të jashtëm referuar sa më lart.




Lista e shkurtimeve

DVV-	Dosja e Vetëvlerësimit
DGJH -	Departamenti i Gjuhëve të Huaja
ECTS-	European Credit Transfer System
UE-	Universiteti i Elbasanit
FSHH-	Fakulteti i Shkencave Humane
GVB-	Grupi i vlerësimit të brendshëm
GVJ -	Grupi i vlerësimit të jashtëm
MAS-	Ministria e Arsimit dhe Sportit
PAE-	Personel Akademik Efektiv
PAK-	Personel Akademik me Kohë të Kufizuar
NJSBC-	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
QSHA-	Qendra e Shërbimeve Arsimore
RVB-	Raport i Vlerësimit të Brendshëm
STP-	Studimi i Tregut të punës
SZHFSSH-	Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Humane
SZHUINEL-	Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Elbasanit
DSKSBC-	Drejtoria e Standarteve, Kurrikulës dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
KPIGSCPS-	Komisioni i Përhershëm Institucional për Garantimin e Standarteve të Cilësisë së Institucionit dhe Programeve të Studimit
KPCFSHH-	Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë dhe Programeve të Studimit në Fakultetin e Shkencave Humane

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Gjuhë Angleze"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Referuar Raportit të Brendshëm të Vlerësimit (RVB), si edhe duke u mbështetur në dokumentacionin shoqërues në Dosjen e Vetë vlerësimit, (DVV), Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) konstaton se Institucioni i Arsimit të Lartë publik Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, referuar në këtë Raport Vlerësimi me shkurtimin (UE) i licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.414 dt. 12.11. 1991, ka hapur degën e gjuhës angleze me VKM Nr. 300, datë 21.06. 1994, e cila ka qenë aktive që nga hapja e saj (Ref. 1.26 Urdhër "Për hapjen e Fakultetit të Shkencave Humane"- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 414, dt. 12.11.1991; Ref. 1.24 Urdhri për hapjen e programit të studimit "Bachelor në Gjuhë Angleze"). Aktualisht UE, përbëhet nga 5 fakultete, ku studiohet me kohë të plotë në programet e studimit: "Bachelor", "Master professional", "Master i Shkencave", "Diplomë profesionale 2-vjeçare" si dhe "Doktoratë". GVJ konstaton se Programet e studimit që UE ofron janë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimin Shkencor (Ref.Ligji Nr.80/2015), nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare (Ref.1 Statuti i UNIEL; Ref. 1.3 Strategjia e UNIEL).</p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" është ofruar nga departamente me emërtime të ndryshme ndër vite si: Departamenti i Gjuhës Angleze; Departamenti i Gjuhës Angleze dhe Gjermane dhe aktualisht me Vendim të Senatit Akademik, Nr.29, dt. 9.11.2021 "Për Riorganizimin e dy Njësive bazë në Fakultetin e Shkencave Humane", ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, në Fakultetin e Shkencave Humane (Ref. 1.21 Vendimi për hapjen e Departamentit të Gjuhëve të Huaja).</p> <p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" ofrohet në përputhje me Kuadrin Ligjor për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor (Ref.Ligji Nr.80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë") dhe në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë së tij (Ref.1.1 Statuti i UE, (Neni 2-Misioni i UE); Ref.1.3 Strategjia e UNIEL)</p>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të	GVJ konstaton nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në DVV, se Programi "Bachelor" në "Gjuhë Angleze" është program i Ciklit të Parë të Studimeve i organizuar me kohëzgjatje normale 3 vite



strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.

akademike dhe me një total 180 Kredite (ECTS), i cili ofrohet nga Departamenti i i Gjuhëve të Huaja, (DGJH), Fakulteti i Shkencave Humane. GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të veprimtarisë së Strategjisë së Zhvillimit Institucional, 2020-2024, e cila bazohet në nenin 57, pika 7, të Kushtetutës, në ligjin nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" (Ref. 1.3 **Strategjia e UNIEL**).


GVJ evidenton se programi i studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" ofrohet dhe zbatohet në përputhje me Statutin dhe Rregulloren Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Humane (Ref. 1.4 **Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL**; Ref. 1.7 **Rregullore e FSHH-së**), si dhe Rregulloren e Programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze". Kjo rregullore synon formimin e specialistëve të lartë në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, garanton përcjelljen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, dhënien e njohurive të thelluara në gjuhën angleze nëpërmjet gërshetimit të informacionit shkencor për kulturën, letërsinë dhe historinë Britanike dhe Amerikane, duke i aftësuar studentët në fushën dhe drejtimin akademik të studimit të gjuhës angleze, duke i mundësuar atyre zgjedhjen e programeve të studimit të Ciklit të Dytë dhe të Tretë, pas përfundimit të tij (Ref.1.8 **Regullore e programit të studimit**).

Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

GVJ konstaton se Institucioni i Arsimit të Lartë publik "Universiteti i Elbasanit", është licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.414, dt. 12.11. 1991 pas riorganizimit të kryer në vitin 1991, duke kaluar nga kategoria "Instituti i Lartë Pedagogjik", (1971-1991), në statusin "Universitet" (Ref. 3. **-Procedura ASCAL- Të dhënat Institucionale, Shkresë Për vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 414, dt. 12.11.1991**). UE ka në përbërje të tij 5 njësi kryesore: a. Fakulteti i Shkencave të Natyrës; b. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike; c. Fakulteti i Shkencave Humane; d. Fakulteti i Shkencave të Edukimit; e. Fakulteti Ekonomik. Në nivel njësie kryesore, struktura akademike përbëhet nga: a. Asambleja e personelit Akademik; b. Dekanati; c. Dekani; d. Zëvendësdekani/ët, të cilat janë në funksion të realizimit të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze", i cili ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Humane, DGJH (Ref.1.1 **Statuti i UE**). GVJ konstaton se Dega e Gjuhës Angleze është hapur në UE me VKM Nr. 300 datë 21.06. 1994 dhe ka qenë aktive që nga hapja e saj (Ref. 1.24 **Urdhri për hapjen e programit të studimit "Bachelor në Gjuhë Angleze"**. Ref. 1.21 **Vendimi për hapjen e Departamentit të Gjuhëve të Huaja**).

GVJ konstaton se FSHH ka një numër total (87) personel akademik, nga të cilët personel akademik efektiv (PAE) (49), personel akademik

	<p>me kontratë (PAK) (38) dhe (1) personel ndihmës akademik (Ref. Aneks tabela Nr.1. Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë).</p> <p>Profesorati i Departamentit të Gjuhëve të Huaja, për vitin akademik 2021-2022, përbëhet nga 46 PAE në total, nga të cilët (24) personel akademik efektiv (PAE), të kategorive:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Profesor i asociuar (2) - Doktor i shkencave (19) - Docent (1) - MSC (2) - (1) pesonel ndihmës akademik <p>Titujt dhe grada shkencore lidhen ngushtë me fushën e mësimdhënies, në të cilën lektorët janë angazhuar.</p> <p>Përsa i përket personelit akademik me kontratë (PAK), DGJH ka në total: (21) PAK, nga të cilët Prof. Dr. (1); Dr.(1), MSc. (19) (Ref. Aneks RVB, Tabela përmbledhëse për stafin akademik të Programit të studimit Bachelor "Gjuhë Angleze" Tabela 1). Stafi akademik i këtij programi studimi ka angazhim të vazhdueshëm në fushën e kërkimit shkencor (Ref. 3.18 Të dhëna të plota për kërkimin shkencor të stafit akademik).</p> <p>GVJ konstaton se UE është certifikuar nga Bordi i Akreditimit për akreditimin institucional për gjashtë vite me Vendim Nr. 49, dt. 27.11.2020 dhe demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze". (Ref. 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional).</p>
<p>Kriteri 5.Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", ofron programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze", përpos programeve të tjera Bachelor të studimit për gjuhët e huaja si ajo italiane, gjermane dhe frënge, si dhe një program dyvjeçar profesional jouniversitar "Operator Turistik ne Gjuhë Gjermane", (Ref. Aneks, Tabela 3, Te dhena Tabelore per numrin e programeve ne ciklin e I-re, te II-te dhe te III-te te studimeve, qe ofrohen ne Njesine pergjegjese). Programi i studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze", ofron 180 kredite, realizohet me kohë të plotë në tre vite akademike, i përket nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) (Ref. 1.37 Korniza Shqiptare e Kualifikimeve). GVJ konstaton se plani mësimor i këtij programi studimi përmban veprimtaritë formuese të kategorive (A-E) me lëndët përkatëse sipas VKM 41, "Për elementët e programit të studimit të ofruara nga IAL-të", të cilat janë të kodifikuara dhe përmbajnë kreditet përkatëse. Ky program studimi përfshin fusha ndërdisiplinore të tilla si: stilistikë, letërsi amerikane dhe britanike, histori dhe civilizim amerikan e britanik (Ref. 1.9 Pasqyrimi i Kodifikimit të Lëndëve të Programit të Studimit FSHH; Ref. 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit</p>

	<p>“Bachelor në gjuhë angleze”. Ref. 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në gjuhë angleze”). Referuar dokumentacionit në Dosjen e Vetëvlerësimit, GVJ vëren se diploma e përfituar në përfundim të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” është regjistruar me Urdhër MASH, Nr.266, dt.10.08.2009 me formën Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) ofruar nga FSHH, Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan. (Ref. Të dhënat institucionale ASCAL, Urdhër Nr.266, dt.10.08.2009 “Per regjistrimin e formes se diplomave te nivelit te pare (DNP) te Universitetit "Aleksander Xhuvani", Elbasan). Referuar informacionit në RVB, dhe dokumentacionit shoqërues të tij, GVJ konstaton se diploma është regjistruar me numrin unik të identifikimit 000091 në regjistrin e diplomave të regjistruara në MASR në Republikën e Shqipërisë, më datë 11.05.2018. GVJ vëren se ky kod shprehet me përcaktimin Diplomë të Nivelit të Parë në “Gjuhën Angleze” (Ref. 1.25 Shkresa e MASR per Kodin e programit te studimit).</p> <p>GVJ konstaton se UE ka përditësuar me vendim të Senatit akademik Nr. 18 dt. 22.07.2021, miratimin e përmbajtjes dhe formës së diplomave që lëshohen nga ana e institucionit në përputhje me Udhëzimin nr. 10 dt. 30.3.2020, (Ref. 1.31 Miratimi i përmbajtjes dhe formës së diplomës nga UNIEL). Nga dokumentacioni i paraqitur në DVV, GVJ konstaton se UE, pas këtij vendimi, është në proces për regjistrimin e përmbajtjes dhe formës së diplomave në Qendrën e Shërbimeve Arsimore sipas udhëzimit për Kodin e Programit të studimit (Ref.1.27 Udhëzim për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës dhe procedurës së regjistrimit nga MASR).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) konstaton se Institucioni i Arsimit të Lartë publik Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", i licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.414 dt. 12.11. 1991 ka hapur degën e gjuhës angleze me VKM Nr. 300 datë 21.06. 1994, e cila ka qenë aktive që nga hapja e saj. GVJ evidenton se Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” ofrohet nga Departamenti i gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Humane, UE dhe zbatohet në përputhje me kuadrin ligjor për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, si edhe me kuadrin rregullator të brendshëm të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”. Programi i studimit “Gjuhë Angleze”, i cili i përket nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) ofrohet dhe zbatohet në përmbushje të misionit të institucionit dhe strategjisë së zhvillimit të tij. GVJ konstaton se FSHH ka një numër total personel akademik (87), nga të cilët personel akademik efektiv (PAE) (49), personel akademik me kohë të kufizuar (PAK) (38) dhe (1) personel ndihmës akademik. GVJ konsaton se Universiteti i Elbasanit është në proces për përmbushjen e detyrimit ligjor për kodifikimin dhe regjistrimin e diplomave të</i></p>

	lëshuara nga UE për programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare (detyrimi i regjistrimit së formës së diplomës në Regjistrin Shtetëror në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, QSHA sipas Udhëzimit MASR, Nr.10. dt.30.03.2020).		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Nga vlerësimi i dokumentacionit në DVV dhe informacionit të paraqitur në RVB, konstatohet nga GVJ se UE ka ngritur një strukturë të qartë dhe të plotë organizative, e cila në nivel institucioni përmban strukturat akademike: Senati Akademik i UE-së, Rektorati, Rektori, Zëv.Rektor/ët; struktura ndihmës akademike me karakter administrativ si: Drejtoria e Koordinimit dhe Marrdhëdhënieve me Jashtë, Drejtoria e Kurikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Drejtoria Juridike, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, Drejtoria e BNJ, Drejtoria e Bibliotekës. Strukturat administrative janë: Bordi i Administrimit, Administratori i Institucionit, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Prokurimeve dhe Shërbimeve, Auditi i brendshëm. Të gjitha këto struktura operojnë në përputhje me parashikimin e funksioneve dhe kompetencave të secilës strukturë në Rregulloren e organizimit dhe funksionimit UNIEL (Ref. 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIE; Ref. 1.10 Struktura organizative e UNIEL).</p> <p>GVJ konstaton se institucioni ka hartuar rregullore të posaçme për organizimin dhe funksionimin e institucionit, në tre nivele: në nivel institucional, në nivel njësie kryesore dhe në nivel njësisë bazë (Ref. 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL) me qëllim ngritjen e marrëdhënieve të frytshme të bashkëpunimit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse, Secila prej njësisë kryesore dhe bazë, funksionon në përputhje me funksionet dhe kompetencat e parashikuara në Rregulloren e UE-së, por edhe në Rregulloret përkatëse të secilës njësi, (Ref. 1.7 Rregullore e FSHH-se; Ref. 1.14 Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja). GVJ konstaton se UE kryen analizën e vazhdueshme të punës së strukturave të institucionit, duke</p>

	<p>nxjerë përfundime në varësi të realizimit të objektivave për çdo njësi kryesore (5 Fakultete) dhe njësi bazë (25 Departamente), duke dhënë rekomandime e detyra në vijueshmëri të procesit akademik në UE. (Ref. 1. 11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021).</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>GVJ konstaton se në mbështetje të realizimit të objektivave të procesit mësimor dhe objektivave formues të studentëve, të parashikuar në rregulloren e programit të studimit (Ref. 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në Gjuhë Angleze”; Ref.1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL), UE ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi si brenda dhe jashtë vendit. Konkretisht, UE ka lidhur 25 marrëveshje bashkëpunimi jashtë vendit me institucione të arsimit të lartë të llojit: “universitet”, “kolegj”, “institute”; 43 marrëveshje bashkëpunimi me institucione brenda vendit të llojit: ‘universitet’, ‘akademi’, ‘kolegj’, ‘institucioneve publike si: Bashki, Prefekturë, Gjykatë, ‘Kuvendi i SHqipërisë’, ‘fondacione’ dhe ‘organizata’. GVJ konstaton se UE ka patur tregues domethënës në kuadër të ndëkombëtarizimit të programeve të studimit. UE ka lidhur 48 marrëveshje me universitete/akademi/qendra studimore në 15 shtete të huaja në kuadër të Programeve të mobilitetit Erasmus +, të cilat kanë mundësuar mobilitetin e stafit akademik, konkretisht për vitin akademik 2020-2021 në lëvizje hyrëse (7) (incoming) dhe dalëse (19), (outgoing). Lidhur me mobilitetin e studentëve, në drejtimin dalës (outgoing) UE ka patur 28 studentë dhe në atë hyrës, (incoming), UE ka patur 2 studentë. (Ref 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021; Ref. 1.30 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.pdf). GVJ vlerëson se objektivat e procesit mësimor dhe objektivat formues të studentëve janë përmbushur në kuadër të zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit që UE ka vendosur.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Për realizimin e Programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, GVJ konstaton mbështetur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues se UE demonstroi se ka lidhur marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, por të cilat nuk janë lidhur posaçërisht për programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze, pasi ky program studimi nuk e ka të përfshirë praktikën profesionale në planin mësimor të tij.</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion</p>	<p>GVJ konstaton se departamenti i gjuhëve të huaja , i cili ofron programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, harton raporte analitike të përfitimeve të marrëveshjeve të bashkëpunimit, nga të cilat rezultojnë se stafi akademik i DGJH, i cili ofron programin e studimit, ka marrë pjesë në 12 projekte shkencore, kryesisht jashtë vendit. (Ref. 1.30 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve</p>

të realizimit të programit të studimit.

nga marrëveshjet e bashkëpunimit; Ref. 1.28 Raport për veprimtarinë e programit të studimit “Bachelor në Gjuhë Angleze” për periudhën 2016-2022) .

GVJ u informua nga vizita në institucion, në takimin me drejtuesin e departamentit të gjuhëve të huaja, se pedagogët e këtij programi studimi, përveç mobiliteteve në kuadër të projekteve ndërkombëtare, u jepej mundësia për të lëvizur dhe bashkëpunuar me institucione me të cilat UE ka lidhur marrëveshje mirëkuptimi për qëllime akademike si: ndjekja e konferencave kombëtare/ndërkombëtare, angazhimi në procesin mësimor në IAL të huaja/vendase, si edhe angazhimin në borde editoriale apo komitete vlerësuese shkencore të revistave shkencore të huaja ose në vend (**Ref. Takimi në institucion; Ref. 1.30 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; Ref 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021).**

Konkluzione

GVJ konstaton se institucioni ka hartuar rregullore të posaçme për organizmin dhe funksionimin e institucionit, në tre nivele: në nivel institucional, në nivel njësie kryesore dhe në nivel njësisë bazë, me qëllim ngritjen e marrëdhënieve të frytshme të bashkëpunimit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse. UE ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi si brenda dhe jashtë vendit. Konkretisht, UE ka lidhur 25 marrëveshje bashkëpunimi jashtë vendit me institucione të arsimit të lartë të llojit: “universitet”, “kolegj”, “institute”; 43 marrëveshje bashkëpunimi me institucione brenda vendit të llojit: ‘universitet’, ‘akademi’, ‘kolegj’, ‘institucioneve publike si: Bashki, Prefekturë, Gjykatë, ‘Kuvendi i Shqipërisë’, ‘fondacione’ dhe ‘organizata’. GVJ konstaton se UE ka patur tregues domethënës në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit. UE ka lidhur 48 marrëveshje me universitete/akademi/qendra studimore në 15 shtete të huaja në kuadër të Programeve të mobilitetit Erasmus +, të cilat kanë mundësuar mobilitetin e stafit akademik, konkretisht për vitin akademik 2020-2021 në lëvizje hyrëse (7), (incoming) dhe dalëse (19), (outgoing). Lidhur me mobilitetin e studentëve, në drejtimin dalës (outgoing), UE ka patur 28 studentë dhe në atë hyrës, (incoming), UE ka patur 2 studentë.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1												
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.												
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve											
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Struktura organizative e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” mbështetet në bazën ligjore të përcaktuar në LAL, nr 80/2015 dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve dhe siguron vlerësimin e lëndëve dhe moduleve me kredite (ECTS). Cikli i parë i studimeve Bachelor në “Gjuhë Angleze” shtrihet përgjatë tre viteve akademike dhe studentët sigurojnë 60 kredite për secilin vit (180 në total).</p> <p>Pas shqyrtimit të materialit plotësues të përfshirë në DVV, GVJ konstatoi se në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” përcaktohen ndarjet e lëndëve në semestra, numri i krediteve për secilën lëndë dhe numri i orëve të zhvilluara brenda dhe jashtë auditorit. Programi i studimit mbështet në rregullat, procedurat dhe detyrat e përcaktuara në rregulloren e programit të studimit. [Ref. 3.16 Plani mësimor për programin e studimit; Ref. 1.8 Rregullore e programit të studimit, kreu III, neni 10, pika 3; Ref 3.17 Programet mësimore të lëndëve]</p>											
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Pas shqyrtimit të planit mësimor të programit të studimit pjesë e dokumentacionit të bashkangjitur në dosjen e vlerësimit dhe pas takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” përmes lëndëve dhe moduleve synon të krijojë një formim të plotë gjuhësor dhe kulturor të studentëve, duke u ofruar atyre një gamë të gjerë fushash studimi si gjuhësi, komunikim, përkthim etj. Përzgjedhja e fushave dhe disiplinave u jep mundësi studentëve që në nivel praktik, të venë në zbatim njohuritë e tyre në përputhje me kërkesat e tregut të punës, kryesisht në fushën e turizimit, medias, përkthim-interpretimit, administratës publike, institucioneve private, sektorit të komunikimit etj. Formimi gjuhësor i studentëve sigurohet përmes marrjes së njohurive të thelluara në disa fusha dhe disiplina të studimeve gjuhësore dhe letrare. Studentëve u jepet mundësia për të përvetësuar një gjuhë të huaj të dytë. Grupi i lëndëve me zgjedhje është i përshatur me nevojat dhe kërkesat e studentëve. [Ref. 1.8 Rregullore e programit të studimit, kreu 1, neni 3; Ref. 3.16 Plani mësimor për programin e studimit]</p>											
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse</p>	<p>GVJ konstaton se struktura e planit mësimor është hartur në përputhje me përcaktimet e bëra në VKM nr. 879/2019 [Ref. 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL; Ref. 2.5 VKM nr. 879, datë 18.12.2019]. Ndarja e veprimtarive në kategori formuese është parashikuar si më poshtë;</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="width: 25%;">Kategoria</th> <th style="width: 25%;">Tipi</th> <th style="width: 25%;">IAL</th> <th style="width: 25%;">Standardi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> </tbody> </table>				Kategoria	Tipi	IAL	Standardi				
Kategoria	Tipi	IAL	Standardi									

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

në kredite.	A	Lëndë Bazë	18.9 %	15 – 20 %
	B	Lëndë karakterizuese	51.1 %	50 – 55 %
	C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	13.3 %	12 – 15 %
	D	Lëndë plotësuese	13.3 %	10 – 15 %
	E	Detyrime përmbyllëse	3.4 %	3 – 5 %
	[Ref. 3.16 Plani mësimor për programin e studimit; Ref. 3.12 Modeli i suplementit të diplomës, pika 4.2; Ref. 1.8 Rregullore e programit të studimit]			
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit të përcjellë përmes DVV, GVJ konstatoi se megjithëse ndarja e lëndëve sipas kategorive të paraqitur në planin mësimor është konform VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 për “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, në të nuk është parashikuar një lëndë “praktikë profesionale” në kategorinë “D”.</p> <p><i>GVJ vlerëson si mangësi në ofrimin e një programi cilësor, mungesën e praktikës profesionale pranë institucioneve të lidhura me objektivat e këtij programi studimi.</i></p> <p>Detyrimet përmbyllëse të studentit kryen në përputhje me përcaktimet e parashtruara në rregulloren e hartuar nga njësia kryesore dhe në rregulloren e programit të studimit dhe realizohen përmes mbrojtjes së punimit të punimit të diplomës (studentë me mesatare mbi 8.5) ose provimit të formimit.[Ref. 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane, Kreu IX, neni 57, 58 Ref. 1.8 Rregullore e programit të studimit, kreu VI, neni 25, pika 2, neni 26, pika ; Ref. 3.15 Korrniza konceptuale e programit të studimit]</p>			
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për	<p>GVJ konstatoi se financimi i studentëve nga institucioni i arsimit të lartë përfshin dy kategori; studentët me rezultate të shkëlqyera dhe studentët që përjashtohen nga tarifa e studimit në përmbushje të kriterëve të përcaktuara nga aktet nënligjore. Vendimi i Bordit të Administrimit përcakton edhe procedurat që duhet të ndiqen për rregjistrimin. [Ref. 2.1 Vendimi i Bordit të Administrimit për bursat dhe përjashtimet]</p>			

arsimin.	
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin pëlësues të vënë në dispozicion nga GVB konstatoi se plani mësimor i zbatuar për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” është hartuar në përputhje me përcaktimet e bëra në LAL 80/2015 dhe siguron përputhjen në emërtesë dhe përmbajtje në masën e parashikuar në ligj duke mundësuar njohjen dhe transferimin e studimeve nga ky institucion drejt IAL-ve të tjera. [Ref. 3.16 Plani mësimor për programin e studimit; Ref. 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL; kreu VI, neni 50,51,52,53]
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” mban kodin GJA. Ky kod shoqërohet me akronimet përkatëse për secilën lëndë/ [Ref. 3.16 Plani mësimor për programin e studimit; Ref. 1.9 Pasqyrimi i kodifikimit të lëndëve të programit të studimit]
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	N/A
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se programi i studimit mbështet në rregullat, procedurat dhe detyrat e përcaktuara në rregulloren e programit të studimit. Plani mësimor i zbatuar për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” është hartuar në përputhje me përcaktimet e bëra në LAL 80/2015 dhe siguron përputhjen në emërtesë dhe përmbajtje në masën e parashikuar në ligj. Ky program, përmes lëndëve dhe moduleve synon të krijojë një formim të plotë gjuhësor dhe kulturor të studentëve, sikurse dhe u krijon mundësi që në nivel praktik, njohuri të tyre të vihen në zbatim në përputhje me kërkesat e tregut të punës. GVJ konstaton se struktura organizative e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, në të nuk është parashikuar një lëndë “praktikë profesionale” në kategorinë “D”, bazuar te VKM Nr. 41, datë 24.10.2018 për “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. GVJ vlerëson si mangësi në ofrimin e një programi cilësor, mungesën e praktikës profesionale pranë institucioneve të lidhura me objektivat e këtij programi studimi.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve										
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, si njësi bazë, pjesë përbërëse e strukturës organizative të Fakultetit të Shkencave Humane. GVJ konstaton se funksionimi dhe organizimi i njësive kryesore Fakultetit të Shkencave Humane dhe njësive bazë të tij kryhet në përputhje me detyrimet ligjore dhe aktet nënligjore të përcaktuara në LAL 80/2015, udhëzimit 27/2016 të MASR sikundër dhe me statutin dhe rregulloren e UE-së . [Ref. 1.1 Statuti i UNIEL; Ref. 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të UNIEL; Ref 1.14 Rregullore e departamentit]</p> <p>Departamenti i Gjuhëve të Huaja përfshin në strukturën e tij katër grupe mësimore/kërkimore shkencore. Personeli akademik i DÇJH-së përbëhet nga 24 pedagogë efektivë.</p> <p>Grupi mësimor i gjuhës angleze ka në përbërjen e tij 14 pedagogë efektivë, të cilët mbulojnë ngarkesën mësimore të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” në masën 100%. [Ref. 1.8 Rregullore e programit të studimit, kreu 2, neni 9; Ref. 4.18 Ngarkesa mësimore për vitin akademik 2021-2022]</p> <p>Bazuar tek dokumentacioni mbështetës i vënë në dispozicion nga GVV, GVJ konstaton se për vitin akademik 2021-2022 të dhënat për stafin akademik të grupit mësimor të gjuhës angleze pasqyrohen si më poshtë ;</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Grupi mësimor i gjuhës angleze</th> <th>PAE</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr.</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof. As. Dr.</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr. / PhD.</td> <td>12</td> </tr> <tr> <td>MSc.</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table>	Grupi mësimor i gjuhës angleze	PAE	Prof. Dr.	-	Prof. As. Dr.	1	Dr. / PhD.	12	MSc.	1
Grupi mësimor i gjuhës angleze	PAE										
Prof. Dr.	-										
Prof. As. Dr.	1										
Dr. / PhD.	12										
MSc.	1										

	Në total	14	
	<p>Me qëllim përmbushjen e ngarkesës mësimore për nevoja të programeve të tjera të studimit të UE, për vitin 2022-2023 grupi mësimor i gjuhës angleze ka angazhuar 13 pedagogë PAK. [Ref. 2.6 Urdhër nr. 121, Për emërimin e personelit akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2022-2023]</p>		
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Bazuar te materiali i përcjellë përmes DVV dhe vizitave të kryera pranë institucionit, GVJ konstaton se në mbështetje të mirëfunksionimit të veprimtarisë mësimore, FSHH-ja ka vënë në dispozicion të DGJH-së një personel ndihmës akademik(laborant), ndërsa gjatë takimeve të kryera në mjediset e sekretarisë mësimore u konstatua se sekretaria mësimore kryente funksionet administrative në përmbushje të nevojave të të gjithë FSHH-së. GVJ verifikoi gjatë vizitës në institucion regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave. [Ref. 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të UNIEL]</p>		
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Detyrat dhe funksionet e përgjegjësit të njësisë bazë janë përcaktuar në rregulloren e organizimit të UNIEL. Përgjegjësi i departamentit organizon, koordinon dhe siguron mirëfunksionimin e veprimtarisë brenda njësisë duke përmbushur detyrimet ligjore të përcaktuara sipas ligjit nr 80/2015. Përgjegjësi i departamentit ngarkohet me detyra që lidhen me organizimin e planit mësimor dhe rregullores së programit, menaxhimin e materialit mësimor dhe infrastrukturës mbështetëse, mbikqyrjen e procesit mësimor, organizimin e veprimtarive shkencore dhe koordinimin me njësitë e tjera të FSHH-së etj. [Ref. 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të UNIEL]</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se funksionimi dhe organizimi i njësisë bazë (DGJH), struktura përgjegjëse që ofron programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze", mbështetet në detyrimet ligjore dhe aktet nënligjore të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Në përmbushje të parashikimeve ligjore, personeli akademik i grupit mësimor të gjuhës angleze, i përbërë nga 14 pedagogë efektivë, mbulojnë ngarkesën mësimore të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë angleze" në masën 100%. Në mbështetje të menaxhimit të veprimtarisë mësimore të këtij programi studimi, funksionon sekretaria mësimore dhe personeli ndihmës akademik. Përgjegjësi i departamentit përmbush detyrat e përcaktuara në bazën ligjore dhe koordinon, menaxhon, mbikqyr dhe organizon veprimtarinë mësimore, shkencore dhe administrative.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV, përcjellë për GVJ, rezulton se njësia përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, DGJH-ja siguron dhe ofron informacionim e nevojshëm në lidhje me programin e studimit, planin mësimor, rregulloren e programit sikurse dhe jep të dhëna të detajuara mbi objektivat, përshkrimin e programit, elementët përbërës të tij, strukturën akademike përgjegjëse dhe strukturat mbështetëse, kriteret e pranimit, stafin akademik, programin lëndor, mënyrat e vlerësimit dhe diplomën. [Ref 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL]</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Mbështetur tek të dhënat e përcjella përmes DVV, konstatohet se plani mësimor dhe rregullorja e programit të studimit strukturon dhe detajon organizimin e programit mësimor në lëndë, module, aktivitete formuese dhe praktike në përputhje me detyrimet ligjore në fuqi. [Ref. 3.16 Plani mësimor për programin e studimit]</p> <p>Po sipas të njëjtave burime, GVJ vëren se veprimtaritë formuese ndahen në lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe klasifikohen sipas kategorive;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A, Lëndë bazë: 34 kredite, (6 lëndë të detyrueshme); - Kategoria B, Lëndët karakterizuese 92 kredite (23 lëndë të detyrueshme); - Kategoria C, Lëndët ndërdisiplinore: 24 kredite (5 lëndë me përzgjedhje); - Kategoria D, Lëndët plotësuese, 24 kredite (5 lëndë me përzgjedhje); - Kategoria E, Detyrimet përmbyllëse, 6 kredite
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se kushtet dhe kriteret e pranimit të studentëve në këtë program studimi përcaktohen në rregulloren e IAL-së [Ref 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL, kreu 2, neni 14; Ref. 1.1 Statuti I UNIEL; Ref 1.23 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit në programin e studimit]</p> <p>Përgjegjësi i njësisë bazë përcakton kuotat dhe kriteret e pranimit dhe ia paraqet dekanatit për ndjekje të procedurave të mëtejshme. Pas shqyrtimit të dokumentacionit plotësues të DVV, rezultoi se Statuti i</p>



	<p>Universitetit dhe Rregullorja e institucionit përcakton gjithashtu dhe procedurat që duhen ndjekur për transferim dhe ekuivalentim të studimeve. [Ref 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL, kreu 2, neni 14; Ref. 1.1 Statuti I UNIEL; Ref 1.22 Vendim për miratimin e kritereve të pranimit në programin e studimit]</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Pasi shqyrtoi dokumentacionin e përfshirë në DVV, GVJ konstatoi se në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” përcaktohet qartë organizimi i lëndëve në semestra (6 semestra me nga 15 javë secili) sikurse dhe ngarkesa mësimore në auditor e cila përlllogaritet me 700 orë dhe puna individuale e studentit 800 orë (1500 orë në total). Referuar të dhënave statistikore të marra përmes DVV rezulton se ngarkesa totale në auditor për studentët e programit Bachelor në “Gjuhë Angleze” është 850 leksione; 1090 seminare, 45 ushtrime/laboratorë.</p> <p>Programet lëndore (syllabus-et) përfshijnë në përmbajtjen e tyre elementë specifikë të lidhur me numrin e leksioneve/seminareve, detyrave të kursit, projekteve, eseve dhe provimeve. Në varësi të natyrës dhe përmbajtjes së lëndës përcaktohen edhe rregullat e frekuentimit, sistemi dhe mënyra e vlerësimit sikurse dhe forma e provimit. [Ref. 3.17 Programet mësimore të lëndëve]</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>GVJ konstatoi përmes dokumentacionit dhe takimeve të kryera me personelin akademik se programet lëndore përditësohen përpara fillimit të çdo viti akademik. Përmbajtja e tyre, sikurse dhe plani mësimor rishikohet dhe përmirësohet në mënyrë periodike. Ndryshimi dhe përditësimi vjen si nevojë për përshtatje ndaj ndryshimeve të vazhdueshme të tregut të punës ose dinamikave të brendshme të zhvillimit. [Ref 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL, kreu 2, neni 20]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se organizimi dhe strukturimi i planit mësimor dhe rregullores së programit në lëndë, module, aktivitete formuese dhe praktike, është kryer në përputhje me detyrimet ligjore në fuqi. Ndarja e veprimtarive formuese në lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe klasifikimi sipas kategorive përkatëse është bazuar te udhëzimet dhe përcaktimet ligjore. Plani mësimor përcakton qartë organizimin e lëndëve në semestra dhe ngarkesën mësimore. Programet lëndore, të cilat përditësohen periodikisht, përcaktojnë numrin e leksioneve/seminareve, detyrave të kursit, projekteve, eseve dhe provimeve, rregullat e frekuentimit, sistemin dhe mënyrën e vlerësimit dhe formën e provimit.</p>


Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Referuar informacionit të përcjellë përmes DVV, rezultoni se përmbajtja e veprimtarive mësimore i ofron studentëve dije të thelluara dhe mundësi për formim shkencor në fushën e studimeve gjuhësore, letrare, kulturore si dhe aftësi praktike në mësimdhënie, përkthim dhe komunikim, marrëdhënie me publikun etj. Falë këtij formimi, studentët e diplomuar në programin e ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë angleze” mund të vazhdojnë studime më të thelluara në programet Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, Master i Shkencave në “Gjuhësi”, Master Shkencor në “Trashëgimi Kulturor” apo Master në fushën e gazetarisë . [Ref. 1.8 Rregullore e programit të studimit, kreu 1, neni 3; Ref. 3.16 Plani mësimor për programin e studimit]</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstaton se shpërndarja e ngarkesës mësimore gjatë gjithë ciklit të parë të studimeve synon përmbushjen e rezultateve të të nxënit dhe mundëson pajisjen e studentëve me kompetencat dhe shprehitë bazë. Raporti teori-praktikë shpeshherë reflektohet me një numër të shtuar të orëve të seminarit, zgjedhje e diktuar nga natyra e lëndës apo nevoja për zhvillimin e veprimtarive praktike gjatë procesit të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Pas verifikimit të strukturës së programit dhe përmbajtjes së programeve lëndorë, GVJ konstatoi se vlerësimi në këtë program studimi kryhet në përputhje me sistemin evropian të transferimit të krediteve(ECTS) dhe se lëndët e ofruara sigurojnë rezultate të të nxënit në përputhje me dhe të krahasueshme me standardet ndërkombëtare për aftësi, njohuri dhe kompetenca. Struktura e programit Bachelor përafrohet me programe të ngjashme ndërkombëtare, gjë që krijon mundësi për shkëmbim përvojash të stafit akademik dhe të studentëve, mundësuar nga marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara brenda programit Erasmus+.</p> <p>Nga të dhënat e siguruar përmes RVV mbi raportin periodik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, GVJ konstaton se për vitin akademik 2021-2022 kanë marrë pjesë në programet e mobilitetit</p>

	<p>3 studentë dhe 5 anëtarë të stafit akademik; për vitin 2020-2021 1 personel akademik dhe për vitin 2019-2020 1 pjesëtar i stafit.</p> <p>[Ref. 3.14 Struktura e programeve të studimit të FSHH-së për të tri ciklet e studimit; Ref 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL, kreu VI, neni 50,51,52, 53 Ref. 1.30 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit]</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Dokumentacioni i shqyrtuar përcakton se shpërndarja e lëndëve brenda kurrikulës synon arritjen e objektivave formues të programit të studimit. Ndarja e këtyre veprimtarive parashikohet në shtojcën nr. 2 të VKM nr. 41, datë 24.10.2018, ku përcaktohet qartë se përqindjen më të madhe duhet ta zenë lëndët karakterizuese. Përqindja e krediteve që përcaktojnë ngarkesën e lëndëve është shprehur si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A, Lëndë bazë: 18.9 % - Kategoria B, Lëndët karakterizuese: 51.1% - Kategoria C, Lëndët ndërdisiplinore: 13.3% - Kategoria D, Lëndët plotësuese: 13.3% - Kategoria E, Detyrimet përmbyllëse; 3.4% <p>[Ref. 1.8 Rregullore e programit të studimit, kreu 1, neni 3; Ref. 3.16 Plani mësimor për programin e studimit]</p>
<p>Kriteri 5. Syllabusët (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit plotësues të dhënë në DVV dhe vizitave të kryera në institucion me personelin akademik, u konstatua se rishikimi dhe përditësimi i programeve lëndore bëhej në mënyrë të vazhdueshme dhe pedagogët synonin përshtatjen e përmbajtjes së syllabuseve me politikën arsimore në vend dhe me kërkesat dhe nevojat gjithmonë e në rritje të studentëve. GVJ konstaton se struktura e hartimit të programit lëndor përfshin elementët e detyrueshëm të përcaktuar në shtojcën 2 të VKM nr. 41, datë 24.10.2018. [Ref. 3.17 Programet mësimore të lëndëve]</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>GVJ gjykon se shpërndarja dhe përmbajtja e lëndëve synon përmbushjen e objektivave të parashikuara të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”. Përveç dijeve dhe njohurive të marra për fusha të caktuara studimi, si studime gjuhësore dhe letrare, histori dhe qytetërim apo përkthim dhe interpretim, studentët pajisen me aftësi të veçanta të thelluara në përshtatje me tregun e punës. Programi kombinon teorinë me praktikën duke nxitur tek studentët të menduarit krijues dhe kritik. [Ref. 3.16 Plani mësimor për programin e studimit; Ref 3.12 Modeli i suplementit të diplomës së programit të studimit]</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e</p>	<p>DVV përmban informacion të detajuar lidhur me përmbajtjen e programeve të studimit. Dijet dhe njohuritë e fituara gjatë studimeve në ciklin e parë u japin studentëve mundësinë për vazhdimin e ciklit të</p>




<p>mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>dytë në programet Master Profesional dhe Master i Shkencave. Formimi profesional i përfutur në disiplina si përkthimi, interpretimi dhe komunikimi i orienton studentët drejt punësimit në sektorë të ndryshëm si turizëm, shërbime, gazetari. Referuar pyetësorit të zhvilluar nga vetë DGJH me Alumni, GVJ konstatoi se nga 82 persona të anketuar, 65% ishin të punësuar në fushën e arsimit parauniversitar, ndërsa 35% në sektorë të tjerë si telekomunikacion, asistent zyre, biznes privat, organizta joqeveritare etj. [Ref. 5.12 Pyetësor i Alumni zhvilluar nga departamenti]</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se në dokumentacionin e përcjellë dhe të shqyrtuar përcaktohen qartë veprimtaritë mësimore të cilat u ofrojnë studentëve dije të thelluara, kompetenca dhe shprehje bazë në kuadrin e formimit shkencor dhe aftësimin profesional. Objektivat e të nxënësve përmbushen duke nxitur tek studentët të menduarit krijues dhe kritik dhe duke i pajisur ata me aftësi të veçanta të thelluara në përshtatje me tregun e punës. Formimi profesional i përfutur në disiplina si përkthimi, interpretimi dhe komunikimi i orienton studentët drejt punësimit në sektorë të ndryshëm.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.5 Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ shqyrtoi dokumentacionin mbështetës të DVV dhe konstaton se përmbajtja e programit dhe përzgjedhja e lëndëve synon të jetë në përputhje me zhvillimet në vend dhe kërkesat e tregut të punës. Pas vlerësimit të planit mësimor, GVJ vëren se përfshirja e një numri shumë të madh lëndësh me zgjedhje synon t'u krijojë studentëve mundësi më të mëdha punësimi falë dhe njohurive më të thelluara që ata marrin në fusha të ndryshme studimi si kulturë , art, kërkim shkencor, marrëdhënie ndërkombëtare, komunikim, media, studime gjinore etj. Gjatë takimeve me personelin akademik të programit të studimit dhe grupin e studentëve u pohua dhe ritheksua nevoja e përfshirjes së këtyre lëndëve dhe interesi gjithnjë dhe në rritje i studentëve për këto fusha interesi. [Ref. 3.16 Plani mësimor për programin e studimit]</p> <p>Duke synuar rritjen profesionale, cilësinë në mësimdhënie dhe përmirësimin e përmbajtjes së lëndëve të programit të studimit,</p>


	<p>personeli akademik është vazhdimisht pjesë e konferencave, projekteve, trajnimeve, programeve të shkëmbimit, forumeve, brenda dhe jashtë vendit. Bazuar tek të dhënat mbi kërkimin shkencor të stafit akademik të DGJH, GVJ konstaton se për vitet akademike 2016-2022, personeli i angazhuar me kohë të plotë pranë kësaj njësie, ka referuar në 133 konferenca shkencore, ka realizuar 103 artikuj shkencorë dhe ka marrë pjesë në 14 projekte të fituara nga DPP dhe si palë e tretë. [Ref. 4.17 CV e personelit akademik]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Në kuadër të bashkëpunimit mes institucionit dhe studentëve, GVJ konstaton se angazhimi i tyre kryhet kryesisht përmes pjesëmarrjes në Këshillin Studentor, dhe përfaqësimit në Senatën Akademik. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni është struktura përgjegjëse për bashkëpunimin dhe koordinimin e punës me studentët gjatë periudhës së studimeve të tyre dhe pas diplomimit. [Ref.2.2 Lista e studentëve në Senatën Akademik; Ref. 2.3 Rregullore e Këshillit Studentor; Ref. 5.12 Pyetësor i Alumni zhvilluar nga departamenti]</p> <p>GVJ konstaton se falë marrëveshjeve të lidhura mes institucionit dhe partnerëve të ndryshëm, studentët e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” kanë marrë pjesë në panairin EU4education si dhe u jepet mundësia që çdo vit të angazhohen në Programin Kombëtar të Praktikave të Punës [Ref.2.7 Të dhëna për punësimin ndër vite FSHH]</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përfshirë në DVV dhe vizitat e kryera në institucion me personelin akademik dhe grupin e studentëve, GVJ pohon se numri i madh i lëndëve më zgjedhje të ofruara në planin mësimor të këtij program studimi (23 të tilla) është në funksion të përmbushjes së kërkesave dhe nevojave të tregut të punës. [Ref. 3.16 Plani mësimor për programin e studimit]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vlerëson se përmbajtja e programit dhe përzgjedhja e lëndëve, veçanërisht atyre me zgjedhje, është përputhje me interesin e studentëve për këto fusha interesi, zhvillimet në vend dhe kërkesat e tregut të punës. Në kuadër të ngritjes profesionale së personelit akademik, PAE i këtij departamenti, ka marrë pjesë në konferenca, projekte, trajnime, brenda dhe jashtë vendit. Studentët e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” janë të organizuar dhe të përfshirë në disa struktura institucionale. Ata gjithashtu kanë marrë pjesë në Panairin e Punës dhe janë të angazhuar në Programin</p>

	<i>Kombëtar të Praktikave të Punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ konstaton bazuar në dokumentacionin shoqërues në DVV dhe informacionin në RVB, se hartimi i planit mësimor për programin Bachelor në "Gjuhë Angleze" është realizuar në mbështetje të Statutit të UE-së (Ref.2.1 Statuti i UE-së, (Neni 48) dhe rregulloreve të posaçme, (Ref. 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Gjuhë Angleze", Neni 10/11/12), të cilat përcaktojnë se programi studimit të Ciklit të parë Bachelor në "Gjuhë Angleze" është i organizuar në 180 kredite sipas sistemit (ECTS), me një shtrirje kohore normale 3 vite akademike dhe veprimtaria mësimore e tij përmban elementë kryesorë të mësimdhënies, nxënies dhe transmetimit të dijeve dhe njohurive nëpërmjet orëve teorike dhe praktike ku përcaktohet ndarja e lëndëve/moduleve në: leksione, seminare, laboratore, detyra e kursi dhe orët e studimit individual, së bashku me numrin e krediteve për lëndët e ofruara në programin e studimit sipas veprimtarive formuese (A-E) / sipas strukturës mësimore në semestra (sem. I-rë dhe i II-të), (Ref.3.16 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në gjuhë angleze"; Ref. 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit "Bachelor në gjuhë angleze"; Ref. Aneks RVB, Tabela 9, Plani mesimor i ndare sipas Veprimtarive Formuese A-E).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>GVJ konstaton nga vizita në institucion se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit "Bachelor në Gjuhë Angleze", i përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve duke iu ofruar forma alternative të mësimdhënies si: krijimi i klasave virtuale të llojit "forume" , "webinar", "blogs" në platformën elektronike Microsoft Teams, të cilat mbanin peshën kryesore gjatë pandemisë 'Covid 19'; dokumentimi i informacionit mësimor në forma vizuale nëpërmjet</p>

	<p>infrastrukturës që UE ofron: përdorimi i laboratorëve për përkthim simultan nëpërmjet sistemit të kabinës së përkthimit; përkthimit të filmave dhe librave; ndjekja e praktikave “exchange students” duke mundësuar vizita në universitete të huaja; burimet në internet dhe praktikave mësimore ndërkombëtare, të cilat personeli akademik i ka përfutur në shkëmbimet e eksperiencës që ka patur me institucione të arsimit të lartë jashtë vendit; ndjekja e disa aktiviteteve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare (Ref. Vizita në institucion; Ref.3.18 Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik të departamentit të gjuhëve të huaja 2016-2022; Ref. 4.6 Te dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit të Shkencave Humane).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>UE në mbështetje të personelit akademik lidhur me përmirësimin e kompetencave didaktike ka arritur të realizojë përfitime të dukshme nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit, të cilat i kanë mundësuar stafit akademik të departamentit të gjuhëve të huaja pjesëmarrje në 12 projekte shkencore, kryesisht për mësimdhënie jashtë vendit, por edhe trajnime. (Ref. 1.28 Raport për veprimtarinë e programit të studimit “Bachelor në Gjuhë Angleze” për periudhën 2016-2022). UE në përbërje të strukturës së tij organizative, ka ngritur Drejtorinë e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me jashtë, e cila është përgjegjëse për ndërkombëtarizimin e programeve të studimit dhe mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve (Ref.3.2 Të dhëna për mobilitetin e personeleve FSHH). Nga pikëpamja e infrastrukturës në rolin që ajo ka në përmirësimin e kompetencave didaktike, UE ka pajisur personelin akademik me kompjutera (desktop) si dhe ka mundësuar akses në internet në zyrat e tyre (Ref. 4.6 Te dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit të Shkencave Humane)</p> <p>GVJ u informua nga vizita në institucion, në takimin me drejtuesin e departamentit të gjuhëve të huaja, se personeli akademik i këtij programi studimi, përveç mobiliteteve në kuadër të projekteve ndërkombëtare, u jepet mundësia për të ndjekur konferenca kombëtare/ndërkombëtare me tarifa minimale në kuadër të nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit që UE ka patur me IAL, në vendin tonë dhe jashtë tij. Kryesisht një mbështetje domethënëse kanë qenë nga ana e organizatës “ELTA”, dhe për botimin e artikujve shkencorë me tarifa të ulëta nga ana e personelit akademik të DGJH, GVJ u informua për revistën shkencore “Journal Anglisticum”. Gjithashtu personeli akademik ka mundësinë të marrë pjesë në konferencat e organizuara nga UE, si edhe të botojë në Buletinin Shkencor të UE-së. (Ref. Takimi në institucion; Ref. 1.30 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; 3.18 Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik të departamentit të gjuhëve të huaja 2016-2022.pdf Ref</p>

<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021, Ref. 3.4 Të dhënat mbi revisten periodike BULETINI UNIEL).</p> <p>GVJ, nëpërmjet vëzhgimit të raporteve të hartuara nga departamenti i gjuhëve të huaja dhe nga UE në nivel institucional, si edhe nga CV-të e personelit akademik për kërkimin shkencor dhe rritjen akademike në tre vjeçarin e fundit konstaton se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi për vitin akademik 2021-2022, është i përbërë nga (14) PAE në total, të kategorive: Profesor i asociuar (1), Doktor i shkencave (12), MSC (1), tituj të cilët lidhen ngushtë me fushën e mësimdhënies, në të cilën lektorët janë angazhuar. Përsa i përket personelit me kontratë, DGJH përbëhet nga (21) PAK në total, nga të cilët, Prof. Dr., (1) MSc. (19) dhe një (1) staf ndihmës akademik. (Ref. Aneks RVB-Tabela përmbledhëse, Nr.1 dhe 2, Personeli akademik për Programin e Studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” Tabela 1).</p> <p>GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, ka realizuar: 133 pjesëmarrje në konferenca shkencore; 24 pjesëmarrje në aktivitete shkencore; 105 publikime të artikujve shkencorë; ka fituar dhe zbatuar 14 projekte në nivel departamenti (Ref.3.18 Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik të departamentit të gjuhëve të huaja, 2016-2022; Ref. Aneks RVB -Te dhëna per kerkimin shkencor te stafit akademik, pergjegj es per programin e studimit (Tabela 19); Ref. 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021; Ref. 4.17 CV e personelit akademik te perfshire ne programin e studimit). Nga sa më sipër, GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e Studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studentët mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. (Ref.1.7 Rregullore e FSHH-së; Ref. 1.2 Rregullore e Studimeve të UNIEL; Ref.3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në gjuhë angleze”; Ref. 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) “Bachelor në gjuhë angleze”).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>GVJ konstaton nga dokumentacioni shoqëruar në RVB se Departamenti i gjuhëve të huaja, i cili ofron programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” është angazhuar në vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies nëpërmjet funksionimit të strukturës: “Komisioni i përhershëm për garantimin e standarteve të cilësisë dhe programeve të studimit të FSHH, (KPCFSHH)”. Ky komision ka në përbërje të tij një (1) personel akademik efektiv të Programit Bachelor Gjuhë Angleze, si edhe përfaqësi nga komuniteti i studentëve të FSHH, një (1) student. (Ref. 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme në fakultet). Nga takimi në institucion</p>

	<p>GVJ konstaton se studentët janë të përfshirë në procesin e përmirësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies nëpërmjet pjesëmarrjes në një (1) pyetësor me 13 pyetje të mbyllura, të kategorizuara në dy rubrika: 8 çështje për procesin e mësimdhënies dhe 5 çështje për performancën e pedagogut, si edhe disa pyetje të hapura për problematikën që studentët evidentojnë në procesin e mësimdhënies. GVJ konstaton se këto rezultate janë të përgjithshme në nivel fakulteti (FSHH) dhe nuk raportohen tipikisht për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” (Ref. 6.2 Publikimi i raportit 2021 -2022). Nga takimi me studentët dhe personelin akademik, u evidentua nga GVJ se një formë tjetër, ku studentët janë të përfshirë në vlerësimin e mësimdhënies, është ajo nëpërmjet diskutimeve dhe mendimeve që ata shprehin në takimet informale me personelin akademik.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>GVJ konstaton se UE ka ngritur struktura në nivel institucional dhe në nivel njësisish kryesore (fakultete), të cilat promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Të tilla janë: Drejtoria e Standarteve, Kurrikulës dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSKSBC), e cila garanton cilësinë e kurrikulës dhe monitoron standartet e cilësisë në mësimdhënie; Drejtoria e Koordinimit të marrëdhënieve me jashtë, e cila siguron marrëveshje bashkëpunimi me IAL të huaja dhe zbaton projektet shkencore për motive trajnimi ose mësimdhënieje të personelit akademik. Komisioni i përhershëm për garantimin e standarteve të cilësisë dhe programeve të studimit në FSHH, (KPCFSHH) (Ref. Struktura organizative UNIEL; Ref. 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme në fakultet). 1.17 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Humane.pdf.</p> <p>UE ka realizuar trajnime në nivel institucional për digjitalizimin në mësimdhënie, kryesisht për zhvillimin e procesit mësimor përgjatë periudhës së pandemisë ‘Covid 19’, si edhe ka përmirësuar infrastrukturën mësimdhënëse për t’u përshtatur me metodologjitë e reja në drejtim të rritjes së aftësive në mësimdhënie, siç është pajisja e auditoreve me ekranet “smart”, pajisja e laboratorëve me teknologjinë më të fundit software dhe hardware për lëndën e Fonetikës dhe Fonologjisë, sistemit të përkthimit me kabinë të posaçme për lëndën e Përkthim-Interpretimit (Ref 6.1 Guida e pedagogut Mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams.pdf; Ref. 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit të Shkencave Humane).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni i arsimit të lartë Universiteti i Elbasanit, “Aleksandër Xhuvani” garanton procesin e të nxënies, aftësimin profesional e shkencor me metoda dhe praktika të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve nëpërmjet kompetencës dhe kualifikimit të personelit akademik të tij. DGJH, që ofron programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze, përbëhet nga: (24)</p>

	<p>PAE të kategorive: Profesor i asociuar (2), Doktor i shkencave (19), Docent (1), MSC (2), (1) personel ndihmës akademik; përsa i përket personelit me kontratë DGJH përbëhet nga: (21) PAK, nga të cilët (1) Prof. Dr., (1) Dr., (19) MSc.</p> <p>GVJ konstaton lidhur me personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze", për vitin akademik 2021-2022, është i përbërë nga (14) PAE në total, të kategorive: Profesor i asociuar (1), Doktor i shkencave (12), MSC (1), tituj të cilët lidhen ngushtë me fushën e mësimdhënies, në të cilën lektorët janë angazhuar.</p> <p>GVJ konstaton se personeli akademik DGJH ka realizuar 133 pjesëmarrje me referime në konferenca shkencore dhe 101 publikime të artikujve shkencorë, si dhe ka marrë pjesë në 14 projekte ndërkombëtare. GVJ konstaton se veprimtaria mësimore e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" përcaktohet nga ndarja e lëndëve/moduleve sipas veprimtarive formuese (A-E) dhe në semestra (sem. i I-rë dhe i II-të), ndarja e orëve mësimore në leksione, seminare në auditor dhe orët e studimit individual, së bashku me numrin e krediteve për lëndët e ofruara në programin e studimit është përmbushur sipas ligut në fuqi, VKM 41, "Për elementët e programit të studimit të ofruara nga IAL-të". UE ka realizuar trajnime në nivel institucional për digjitalizimin në mësimdhënie, kryesisht për zhvillimin e procesit mësimor përgjatë periudhës së pandemisë 'Covid 19', si edhe ka përmirësuar infrastrukturën mësimdhënëse për t'u përshtatur me metodologjitë e reja në drejtim të rritjes së aftësive të mësimdhënies, sic është pajisja e auditoreve me ekranet "smart", pajisja e laboratorëve me teknologjinë më të fundit softëare dhe hardëare për lëndët me karakter praktik si: Fonetikë dhe Fonologjisë, Përkthim-Interpretimit dhe Njohuri Komjuteri.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të	Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB-së, GVJ, konstaton se në procesin e ndjekjes së veprimtarive mësimore, kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen qartë në kuadrin rregullator të brendshëm të institucionit, i cili përbëhet nga: Rregullore e studimeve UNIEL (Neni 40/41/42); Rregullore e FSHH-së (neni 37/38); Rregullore e Programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze, (Neni 20), (Ref. 1.2 Rregullore e




<p>posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Studimeve UNIEL; Evidence 1.7 Rregullore e FSHH-se, Ref 1.8 Rregullore e programit te studimit). GVJ konstaton nga dokumentacioni shoqërues dhe nga vizita në institucion se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përlllogaritja e vlerësimit për lëndën përkatëse bëhet nga titullari i lëndës dhe u komunikohet studentëve në fillim të vitit akademik/semestrit. Syllabuset përcaktojnë elementët e testimit dhe vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale sipas formave të kontrollit të dijeve të ndara në kategoritë: 'Frekuentim', 'Vlerësimit i vazhdueshëm', dhe 'Vlerësimit i ndërmjetëm'. Procedura vlerësimit të njohurive dhe sistemi i pikëzimit për vlerësimin e lëndës është përcaktuar në syllabuset e lëndëve sipas VKM 41, dt. 24.1.2018 "Për elementët e Programeve të studimit të ofruar nga IAL. (Ref. 3 .17 Programet mesimore te lendeve; Ref. Rregullore e FSHH-së (neni 37/38).</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstaton se Neni 20 i Rregullores së Programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze", përcakton se format dhe kriteret e vlerësimit shprehen në planin mësimor dhe në programin e lëndës (syllabus-et) (Ref 1.8 Rregullore e programit te studimit; Ref. 3 .17 Programet mesimore te lendeve). GVJ konstaton se Neni 37/pika 4 i Rregullores së FSHH-së përcakton se në programin e lëndës pasqyrohen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat u bëhen të ditura studentit në fillim të procesit mësimor (Ref. Rregullore e FSHH-së, Neni 36/37/38); Ky konstatim u evidentua nga GVJ në takimin me personelin akademik dhe në takimin me studentët.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ konstaton se testimi dhe vlerësimi njohurive të studentëve, të cilët ndjekin Programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" është në përputhje VKM 41, dt. 24.1.2018: "Për elementët e Programeve të studimit të ofruar nga IAL-të". Vlerësimi përfundimtar i lëndës, në këtë program studimi është rezultat i tre treguesve: 1-vlerësim i vazhduar (aktivizimi në seminare dhe leksione gjatë semestrit vitit akademik); 2-vlerësimi i ndërmjetëm gjatë semestrit/ vitit akademik për elementët e përcaktuar në programin e lëndës të llojit: detyra kursi, punë me shkrim, kolokiume, prezantim i projekteve, etj), të cilat marrin jo më pak se 30% të peshës totale në vlerësimin e lëndës; 3-vlerësimi me anë të provimit përfundimtar (me shkrim/me gojë). Vlerësimi i raporteve për ponderimin e përqindjes për secilën kategori vlerësimi bëhet nga pedagogu i lëndës dhe përqitet për miratim në departamentin e Gjuhëve të Huaja (Ref. 1.7 Rregullore e FSHH-së (neni 37/38; Ref. 3 .17 Programet mesimore te lendeve)</p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e</p>	<p>GVJ konstaton nga takimi në institucion me personelin akademik dhe studentët se Departamenti i Gjuhëve të Huaja, përfshin studentët në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies nëpërmjet aplikimit të formave alternative dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>bashkëkohore të mësimdhënies, të cilat mbështeten vullshëm nga studentët e kësaj gjenerate, të tilla si : “klasa ose forume virtuale” , “webinare”, “blogje”, platforma elektronike “Teams”, të cilat mbanin peshën kryesore gjatë pandemisë ‘Covid 19’; dokumentimi i informacionit mësimor në forma vizuale nëpërmjet infrastrukturës që UE ofron, përdorimi i laboratorëve për përkthim simultan, nëpërmjet sistemit të kabinës së përkthimit, përkthimit të filmave dhe librave, ndjekja e praktikave “exchange students” duke mundësuar vizita në universitete të huaja, përdorimi i hartave digjitale, burimet në internet dhe praktikave mësimore ndërkombëtare, që personeli akademik i ka përfutur në shkëmbimet e eksperiencës me institucione të arsimit të lartë jashtë vendit dhe përgjatë ndjekjes së aktiviteteve shkencore dhe trajnimeve bashkëkohore. Studentët dhe personeli akademik përdorin adresat elektronike zyrtare të institucionit, për t`u informuar, si edhe për t`u integruar njëkohësisht në llogaritë e rrjeteve sociale të krijuara nga grupet mësimore-kërkimore në funksion të mbështetjes nga mësimdhënësit dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. (Ref. Vizita në institucion; Ref.1.7 Rregullore e FSHH-se; Ref. 3.17 Programet mesimore te lendeve; Ref. 5.18 Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>				
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, bazuar në dokumentacionin shoqëruar të RVB-së konstaton se kuadri rregullator i brendshëm i UE-së parashikon dhe përcakton rregulla të qarta mbi procesin e ndjekjes së veprimtarive mësimore, kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve, si dhe aftësive profesionale, që shprehen konkretisht me përmbushjen e detyimit ligjor sipas VKM 41, dt. 24.1.2018 “Për elementët e Programeve të studimit të ofruar nga IAL”, ku përfshihen format e kontrollit të dijeve të ndara në kategoritë: 1-“Vlerësim i vazhdueshëm (aktivizimi në seminare dhe leksione gjatë semestrit/ vitit akademik”, 2- “Vlerësimi i ndërmjetëm” me detyra kursi, punë me shkrim, kolokiume, prezantim i projekteve, etj., (të cilat si rregull marrin jo më pak se 30% të peshës totale në vlerësimin e lëndës) dhe 3-“Provimi përfundimtar”. Këto elementë reflektohen në Rregulloren e studimeve UNIEL, Rregulloren e FSHH-së, Rregulloren e Programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, si edhe pjesërisht në programet e lëndëve (syllabuset).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.3

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstaton se testimi dhe vlerësimi i njohurive të studentëve, të cilët ndjekin Programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” është në përputhje me VKM 41, dt. 24.1.2018 “Për elementët e Programeve të studimit të ofruar nga IAL”. Vlerësimi përfundimtar në Programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” është rezultat i tre treguesve: 1- vlerësim i vazhduar (aktivizimi në seminare dhe leksione gjatë semestrit vitit akademik); 2- vlerësimi i ndërmjetëm gjatë semestrit/vitit akademik për elementët e përcaktuar në programin e lëndës të llojit: detyra kursi, punë me shkrim, kolokiume, prezantim i projekteve, etj), të cilat marrin jo më pak se 30% të peshës totale në vlerësimin e lëndës;</p> <p>3- vlerësimi me anë të provimit përfundimtar.</p> <p>Vlerësimi i raporteve për ponderimin e përqindjes për secilën rubrikë vlerësimi, bëhet nga pedagogu i lëndës dhe paraqitet për miratim në departamentin e Gjuhëve të Huaja. Në programin e lëndës shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat u bëhen të ditura studentit në fillim të procesit mësimor. (Ref.1.7 Rregullore e FSHH-së (neni 37/38; Ref. 3.17 Programet mesimore te lendeve)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme, abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ konstaton bazuar në informacionin në RVB dhe takimin në institucion, se UE ka vënë në përdorim sistemin elektronik të vlerësimit për kategorinë “vlerësim i vazhduar” përgjatë Pandemisë “Covid 19”, por nuk e aplikon atë në kushte normale të procesit të vlerësimit të provimeve, për arsye se provimet janë parashikuar jo vetëm me shkrim, por edhe me gojë. GVJ u informua nga vizita në institucion se UE, përveç të tjerave, përdor sistemin elektronik EMS për hedhjen e vlerësimeve të studentëve. (Ref 1.2 Rregullore e Studimeve te Uniel; Ref. 1.7 Rregullore e FSHH-se; Ref. 3. 17 Programet mesimore te lendeve; Ref. 1.8 Rregullore e programit te studimit)</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton nga shqyrtimi i kuadrit rregullator të brendshëm të UE-së, (Rregullore e studimeve UNIEL, Neni 40/41/42; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane, Neni 37/38/39; Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze, Neni 20), si edhe nga shqyrtimi i programeve të lëndëve (syllabuseve), se testimi dhe vlerësimi i njohurive të studentëve, të cilët ndjekin Programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” është në përputhje me VKM 41, dt. 24.1.2018 “Për elementët e Programeve të studimit të ofruar nga IAL-të”.</p> <p>Vlerësimi përfundimtar në lëndët e Programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” mbështetet në format e kontrollit të dijeve të parashikuara në ligj: 1- frekuentimi, 2- kontrolli i vazhdueshëm dhe 3-</p>

	<p>provimi përfundimtar i lëndës.</p> <p>GVJ konstaton se frekuentimi i leksioneve si rregull është fakultativ, por kjo përcaktohet nga rregullorja e njësisë kryesore, dhe nëse është i detyrueshëm nuk kapërcen masën 75%, ndërsa frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm deri në masën 75%, parashikime të cilat janë reflektuar në Nenin 34 të Rregullores UNIEL.; Nenin 13 të Rregullores së Programit të studimit dhe Nenin 31, të Rregullores së FSHH-së.</p> <p>Kontrolli i vazhdueshëm përmban tre elementë:</p> <p>1-vlerësim i vazhduar (aktivizimi në seminare dhe leksione gjatë semestrit vitit akademik);</p> <p>2-vlerësimi i ndërmjetëm gjatë semestrit/vitit akademik për elementët e përcaktuar në programin e lëndës të llojit detyra kursi, punë me shkrim, kolokiume, prezantim i projekteve, etj), të cilat marrin jo më pak se 30% të peshës totale në vlerësimin e lëndës;</p> <p>3-vlerësimi me anë të provimit përfundimtar (provim i formimit, teza e diplomës).</p> <p>GVJ konstaton se Neni 37 i Rregullores së FSHH-së parashikon se përcaktimi i raporteve midis këtyre formave të vlerësimit, bëhet nga pedagogu i lëndës dhe paraqitet në DGJH për miratim dhe më pas shprehet në syllabus-in e lëndës. (Ref. 1.7 Rregullore e Fakultetit; Ref.3 .17 Programet mesimore te lendeve; Ref. 1.8 Rregullore e programit te studimit)</p> <p>GVJ vëren se format e kontrollit të njohurive të paraqitura në tabelën 15 të RVB, reflektojnë ponderimin e përqindjes së vlerësimit sipas Rregullores së FSHH, ku vlerësimi i vazhduar dhe vlerësimi i ndërmjetëm ka 40-60% ndaj totalit. (Aneks RVB.Tabela 15. Format e kontrollit të njohurive).</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>GVJ, duke iu referuar informacionit në RVB dhe vizitës në institucion (takimi me personelin akademik dhe studentët) konstaton se vlerësimi i njohurive shoqërohet me komente me shkrim nga ana e pedagogut të lëndës në rastin e kolokiumeve, detyrave të kursit/projekteve, eseve, por edhe në provimin përfundimtar. GVJ konstaton se të tilla komente, të cilat janë njëkohësisht këshilla mbi procesin e të nxënit, kryesisht gjatë vlerësimit të vazhdueshëm, orientojnë dhe ndihmojnë studentët e Programit Bachelor në Gjuhë Angleze drejt përmirësimit të aftësive të të nxënit në të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>GVJ konstaton se Neni 42/45 i rregullores së FSHH-së dhe Neni 45 i Rregullores së studimeve UNIEL parashikojnë procedurën e zhvillimit të provimit, ku ndalohet hyrja e personave të tretë në mjediset ku zhvillohet provimi, e cila është njëkohësisht masë parandaluese për plagjiaturën ose kopjimin. Kjo rregullore parashikon penalizimin e studentit në kategorinë mbetës në rast të shkeljes së Kodit të Etikës, mbi kopjimin në provime dhe plagjiaturën (Ref. 6.5 Kodi i Etikës UNIEL; Ref. 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL; Ref. 1.7</p>

	<p>Rregullore e FSHH-së). Referuar RVB-së dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se studentëve u ndalohet përdorimi i mjeteve të komunikimit si aparate telefonike, që kompromenton zhvillimin korrekt të provimit. GVJ nuk konstaton nga kuadri rregullator i UE-së, dhe as nga takimi me personelin akademik se DGJH zotëron platforma të veçanta për kontrollin e plagjiaturës për tezat e diplomave ose detyrave të kursit. Kjo mangësi kompensohet pjesërisht nga ana e pedagogëve nëpërmjet përmirësimit të aftësive të studentëve për punën kërkimore dhe shkencore. <u>GVJ rekomandon se rregullorja e programit të studimit dhe rregullorja e diplomimit duhet të përmbajnë parashikime të qarta për kontrollin e plagjiaturës dhe kopjimin në provime dhe detyra, përpos parashikimeve në Kodin e Etikës së UE;</u> (3.11 Rregullore e mikrotezës dhe provimit të diplomimit.pdf Ref. 1.8 Rregullore e programit te studimit)</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive të studentëve të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, përcaktohen në rregulloren e programit të studimit, (Neni 20) dhe në syllabuset e lëndëve. Shkalla e përvetësimit të lëndës vlerësohet me notë (nga 1-10), e cila është rezultat i sistemit të pikëzimit të përcaktuar në rregulloren e programit të studimit, ku nota maksimale është 10, (91-100), dhe nota minimale për të kaluar lëndën është 5, (pikët 41-50). Sistemi i vlerësimit me notë, është i detajuar me anë të sistemit të pikëzimit, përshkrimit me fjalë dhe me shkronjë (A-F), (Ref. 1.8 Rregullore e programit te studimit). GVJ konstaton se vlerësimet e studentëve pasqyrohen brenda 6 ditëve nga zhvillimi i provimit, pasi ngarkohen në sistemin elektronik EMS nga pedagogu titullar i lëndës dhe procesverbali i plotësuar me rezultatin e provimit, i gjeneruar nga sistemi i të dhënave, dorëzohet në sekretarinë mësimore i nënshkruar nga komisioni përkatës (Ref. 1.7 Rregullore e FSHH-së).</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e</p>	<p>GVJ konstaton duke iu referuar RVB-së dhe materialeve në DVV se provimet me shkrim/gojë (në rast se përdoren dokumenta mbështetës) të studentëve ruhen nga pedagogu i modulit/lëndës për një periudhë 1 (një) mujore pas përfundimit të sezonit të provimeve (Neni 42 i rregullores FSHH). Neni 44 i kësaj rregulloreje parashikon të drejtën për ankimim të vlerësimit të studentit, e cila bëhet me shkrim brenda ditës së marrjes së rezultatit, dhe shqyrtohet nga përgjegjesi i departamentit, i cili në rast se e gjykon të drejtë ankesën, ngre një grup ad-hoc rivlerësimi (ku të pranishëm janë pedagogët e komisionit ekzistues të vlerësimit dhe pedagogë të tjerë). Ky proces vlerësimi është i formës së prerë dhe pasqyrohet në sistemin elektronik të notave. Kjo procedurë u konstatua dhe nga takimi me studentët e pranishëm gjatë vizitës në institucion (Ref. 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit te UNIEL, Ref. 1.7 Rregullore e FSHH-se, Ref. 1.8 Rregullore e programit te studimit, Ref. 1.14 Rregullore e</p>

përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Departamentit, Ref. 1.2 Rregullore e Studimeve te Uniel).			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se testimi dhe vlerësimi i njohurive të studentëve, të cilët ndjekin Programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, është në përputhje VKM 41, dt. 24.1.2018 “Për elementët e Programeve të studimit të ofruar nga IAL-të”. Vlerësimi përfundimtar në Programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” është rezultat i tre treguesve: 1-vlerësim i vazhduar (aktivizimi në seminare dhe leksione gjatë semestrit vitit akademik); 2- vlerësimi i ndërmjetëm gjatë semestrit/ vitit akademik për elementët e përcaktuar në programin e lëndës të llojit detyra kursi, punë me shkrim, kolokiume, prezantim i projekteve, etj), të cilat marrin jo më pak se 30% të peshës totale në vlerësimin e lëndë sipas Rregullores së FSHH;</i></p> <p><i>3-vlerësimi me anë të provimit përfundimtar.</i></p> <p><i>GVJ konstaton nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive të studentëve të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” përcaktohen në rregulloren e programit të studimit, Neni 20, si dhe në syllabuset e lëndëve. Shkalla e përvetësimit të lëndës vlerësohet me notë (nga 1-10), e cila është rezultat i sistemit të pikëzimit të përcaktuar në rregullore e programit të studimit, ku nota maksimale është 10 (pikët 91-100) dhe minimale për të kaluar lëndën është 5 (pikët 41-50). Sistemi i vlerësimit me notë, është i detajuar me anë të sistemit të pikëzimit, përshkrimit me fjalë dhe me shkronjë (A-F). Nota pasqyrohet brenda gjashtë ditëve (6) nga zhvillimi i provimit në sistemin elektronik EMS. UE parashikon në Kodin e Etikës kontrollin e plagjiaturës dhe kopjimin në provime dhe detyra, por nuk e ka përfshirë atë specifikisht në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e diplomimit.</i></p> <p><i>GVJ konstaton duke iu referuar RVB-së dhe materialeve në DVV se provimet e studentëve ruhen nga pedagogu i modulit/lëndës për një periudhë 1 (një) mujore pas përfundimit të sezonit të provimeve (Neni 42 i rregullores FSHH). Neni 44 i kësaj rregulloreje parashikon të drejtën për ankimim të vlerësimit të studentit, i cili bëhet me shkrim brenda ditës së marrjes së rezultatit, dhe shqyrtohet nga përgjegjesi i departamentit, i cili ngre një grup ad-hoc rivlerësimi. Vlerësimi që del nga ky process është i formës së prerë dhe pasqyrohet në sistemin elektronik të notave, EMS.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi III.4
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p> <p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i referencës në RVB të planit mësimor për programin e studimit "Bachelor" në "Gjuhë Angleze" konstatohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lëndët bazë (A) zënë 18.8 % nga (15%-20%); - lëndët karakterizuese (B) zënë 51 % (50%-55%); - lëndët ndërdisiplinore (C) zënë 13.3% (12%-15%); - lëndët plotësuese (D) zënë 13.3% (10%-15%); - detyrimet përmbyllëse (E) zënë 3.3% (3-5%); <p>(Ref. 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në gjuhë angleze”; Ref. Aneks RVB, Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese A-E, Tabela 9; Ref. 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit “Bachelor në gjuhë angleze”).</p> <p>GVJ vëren se veprimtaria formuese në këtë plan mësimor (mësimi në auditor dhe jashtë tij) është ndërtuar në funksion të formimit të studentëve. Lëndët karakterizuese të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” shërbejnë në zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve sipas profileve të programit Bachelor në “Gjuhë angleze” (Ref 2.5 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) Tabela 9).</p> <p>GVJ konstaton nga shqyrtimi i planit mësimor të Programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" se lëndët ndërdisiplinore (C) të ofruara për këtë program të tilla si: Anglishtja e Folur dhe e Shkruar; Anglishtja përmes Gjinitive letrare; Variantet e Anglishtes; Njohuri mbi BE; Punë me projekte; PR dhe lëndët plotësuese (D): gjuhë e huaj e dytë (2/3), Njohuri Kompjuterike garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, shkencave humane, komunikimit dhe ndërveprimit. (Ref. Aneks RVB, Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese A-E, 2020-2023, Tabela 9)</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti të përfshira në programin e studimit analizohen në Departamentin e Gjuhëve të huaja çdo fund viti akademik, ku trajtohet mundësia për rishikimin dhe përmirësimin e syllabuseve. <u>GVJ konstaton se vlerësimi i programit të studimit realizohet në nivel fakulteti, dhe nuk përmban të dhëna konkrete për programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze (Ref. 6.2 Publikimi i raportit 2021 - 2022).</u> GVJ rekomandon se kjo procedurë duhet të formalizohet nëpërmjet aplikimit të pyetësorëve të posaçëm për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, ku studentët kanë hapësirë të shprehin opinionin e tyre mbi lëndët e përfshira në programin studimor dhe personelin akademik të angazhuar në programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia</p>	<p>Duke iu referuar dokumentacionit të paraqitur në DVV, konkretisht,</p>

<p>realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>planit mësimor të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” dhe programeve të lëndëve/sylabuset, GVJ konstaton se mësimdhënia realizohet mbi bazën e kompetencave, të cilat janë parashikuar në formën e realizimit të detyrave të kursit, projekteve, eseve, punëve me shkrim, zhvillimit të orëve të mësimit në laborator kryesisht për lëndët karakterizuese (Kategoria B) Përkthim-Interpretim, ‘Fonetikë-fonologji’ dhe lëndës plotësuese (kategoria D) ‘Njohuri kompjuteri’. (Ref. 1.7 Rregullore e Fakultetit.pdf ; Ref.3 .17 Programet mesimore te lendeve; Ref. 1.8 Rregullore e programit te studimit). GVJ konstaton se ky program studimi nuk përmban praktikën profesionale dhe rekomandon futjen në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” në kategorinë e lëndëve plotësuese (D), sipas VKM 41, dt. 24.1.2018 “Për elementët e Programeve të studimit të ofruar nga IAL-të”.(Ref. 3.16 Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”; Ref. Aneks RVB, Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese A-E, Tabela 9).</p> <p>Sipas informacionit të paraqitur në RVB, duke iu referuar programeve të lëndëve (sylabuseve), si dhe planit mësimor, GVJ konstaton se personeli akademik mbështet diskutimet, punën në grup dhe shkrimin e projekteve, duke qenë se në planin mësimor të programit të studimit, në kategorinë (C) të veprimtarive formuese janë të përfshira lëndët: Njohuri mbi BE-në, Punë me projekte dhe Public Relations (PR). Detyra e kursit është parashikuar në çdo sylabus dhe është mundësi konkrete për realizimin e punës në grup. (Ref. 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në gjuhë angleze”; Ref. Evidence 3 .17 Programet mesimore te lendeve).</p> <p>Nga dokumentacioni i paraqitur në DVV konstatohet nga GVJ se personeli akademik krijon kushte të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studimeve të avancuara shkencore dhe u jep mbështetje të studentëve. Referuar RVB-së dhe vizitës në institucion, GVJ raporton se për periudhën nga 2019-2022, studentët e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë angleze” janë angazhuar në (6) projekte shkencore në rang departamenti; 35 studentë në një (1) projekt shkencor në rang fakulteti; 71 studentë në (2) projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë, ku ka patur mobilitet të (3) studentëve në Shtator 2022, në kuadër të Erasmus + “Mobility Cafë”, dhe 5 studentë të përfshirë në punime shkencore individuale të pedagogëve nëpërmjet publikimeve në Buletinin e UNIEL (Ref. Aneks, RVB, Tabela 22 Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë; Ref. 3.2 Te dhena per mobilitetin e personeleve FSHH).</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe</p>	<p>GVJ evidenton se personeli akademik ka realizuar në nivel minimal orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të shkencës dhe teknologjisë, të cilat ofrohen nga personeli akademik, efektiv dhe me kontratë.</p>

<p>seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Kryesisht, kjo mangësi është kompensuar nëpërmjet angazhimit të PA në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. UE ka hartuar një udhërrëfyes për përdorimin e platformës elektronike 'Teams' përgjatë pandemisë Covid 19 (Ref 6.1 Guida e pedagogut Mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams; Ref. 1.19 Analiza vjetore e departamentit të gjuhëve të huaja 2021-2022., Ref. faqja zyrtare elektronike UNIEL https://ëëë.uniel.edu.al/fakultetet/fakulteti-i-shkencavehumane/veprintari). Kryesisht ka patur aktivitete shkencore nga personeli akademik i ftuar në UE. (Ref. 6.4 Lista e Personelit te Ftuar te angazhuar ne FSHH)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Nga shqyrtimi i referencës në RVB të planit mësimor për programin e studimit "Bachelor" në "Gjuhë Angleze", GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lëndët bazë (A) zënë 18.8 % nga (15%-20%); - lëndët karakterizuese (B) zënë 51 % nga (50%-55%); - lëndët ndërdisiplinore (C) zënë 13.3% nga (12%-15%); - lëndët plotësuese (D) zënë 13.3% nga (10%-15%); - detyrimet përmbyllëse (E) zënë 3.3% nga (3-5%); <p>GVJ konstaton se ky program studimi nuk përmban praktikën profesionale dhe rekomandon futjen e saj në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" në kategorinë e lëndëve plotësuese (D), sipas VKM 41, dt. 24.1.2018 "Për elementët e Programeve të studimit të ofruar nga IAL-të".GVJ konstaton se vlerësimi i cilësisë së programit të studimit realizohet në nivel fakulteti, dhe nuk përmban të dhëna konkrete për programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze". GVJ evidenton se personeli akademik ka realizuar në nivel minimal orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të shkencës dhe teknologjisë, të cilat ofrohen nga personeli akademik, efektiv dhe me kontratë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin e përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit</p>	<p>GVJ konstaton se përmbyllja e studimeve për programin Bachelor në "Gjuhë Angleze" kryhet me provim të përgjithshëm përfundimtar ose me punim diplome, sipas Nenit 25 të rregullores së Programit të studimit "Bachelor në Gjuhë Angleze". GVJ konstaton se në Rregulloren e FSHH-së dhe Rregulloren UNIEL (neni 60/pika3) përcaktohet kufiri (8) për mesataren e ponderuar e dy viteve të para të ciklit Bachelor, që i jep</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>të drejtën studentit për punim diplome dhe bëhet publike në fillim të vitit të fundit akademik të studimeve (Neni 9, pika 3 e rregullores së FSHH); (Ref. 1.7 Rregullore e Fakultetit.pdf; GVJ sugjeron që pragu i mesatares për diplomim me temë diploma të përfshihet dhe në rregulloren e programit të studimit (Ref. 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në Gjuhë Angleze”.pdf). GVJ konstaton se Departamenti i gjuhëve të huaja ka hartuar rregullore të posaçme për mikrotezën dhe diplomimin për programin Bachelor në “Gjuhë Angleze”, baza rregullatore e së cilës, është në formatin “Shtojcë”. <u>GVJ konstaton se</u> kjo rregullore nuk përmban elementë të detajuar për provimin përfundimtar të diplomimit dhe nuk është e miratuar në Dekanat. Gjithashtu në këtë rregullore, ndryshe nga rregullorja e FSHH-së, është përcaktuar pragu 7.5 i mesatares për diplomim me temë diplome (Ref. 3.11 Rregullore e mikrotezës dhe provimit të diplomimit).</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Referuar informacionit në RVB, kuadrit të brendshëm rregullator të UE-së dhe takimit në institucion, GVJ u informua se Departamenti i Gjuhëve të Huaja, si strukturë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” informon në çdo drejtim studentët, duke u vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në lidhje me kriteret e diplomimit për dy modalitete: provimi i përgjithshëm përfundimtar dhe punim i temës së diplomës. Në rastin e përzgjedhjes së mbrojtjes me temë diplome, studenti asistohet nga udhëheqësi nëpërmjet grafikut të konsultave për punimin e diplomës. GVJ konstaton se studentët njihen me “Rregulloren e mikrotezës dhe provimit të diplomimit”, si edhe me fondin e pyetjeve të “Programit të provimit të përgjithshëm përfundimtar” (PPP) (Ref.3.11 Rregullore e mikrotezes dhe provimit të diplomimit, Ref. 1.2 Rregullore e Studimeve të Uniel, Neni 62/63). Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar hartohet nga personeli akademik i departamentit dhe miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit për t’ju bërë e ditur më pas studenteve në fillim të vitit të fundit akademik, si edhe publikohet në website-in e UE-së, në mënyrë që studentët të orientohen tek fushat e perzgjedhura (Ref. 1.2 Neni62/ 63 Rregullore e studimeve UNIEL). GVJ konstaton se struktura të tjera përgjegjëse që përfshihen në drejtim të formalizimit dhe informimit të procesit të diplomimit në programin Bachelor në “Gjuhë Angleze” janë Dekanati dhe Sekretaria mësimore (Ref. 1.2 Rregullore e Studimeve të Uniel; Ref. 1.7 Rregullore e FSHH-se, Ref. 1.8 Rregullore e programit të studimit; Ref. 1.14 Rregullore e Departamentit, Ref. 3.11 Rregullore e mikrotezes dhe provimit të diplomimit; Ref. 3. 17. Programet mesimore të lendeve).</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna</p>	<p>GVJ konstaton se për administrimin e provimit final ngrihet një komision i posaçëm i përbërë nga personel akademik (3-5 anëtarë) i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” me propozim të Departamentit të Gjuhëve të Huaja, i cili më pas miratohet</p>

<p>gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>në Dekanat. GVJ konstaton se numri i anëtarëve të Komisionit të mbrojtjes me temë diplomë është me jo më pak se 5 anëtarë (Ref. 1.2 Rregullore e Studimeve te Uniel, Neni 65 /pika 1/2).</p> <p>GVJ konstaton se tezat e provimit të formimit hartohen nga anëtarët e komisionit të provimit, të cilët i përzgjedhin pyetjet nga fondi i krijuar dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit dhe Dekani i FSHH. Provimi përfundimtar organizohet me gojë/me shkrim ose i kombinuar (Neni 63/pika 5/6, Rregullore UNIEL). Tezat e provimit të përgjithshëm përfundimtar hartohen nga anëtarët e këtij komisioni duke përzgjedhur pyetje nga “Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar” (PPP). GVJ konstaton se ky program përfshin pyetje nga fusha e përgjithshme, njëkohësisht e përbashkët për të gjithë studentët, ku përfshihen seksionet: përkthim (10 pikë); e folur (25 pikë); e shkruar (10 pikë) dhe gjuhë praktike (15 pikë), në total e vlerësuar me 60 pikë. Në seksionin e dytë, studentëve u jepet e drejta të zgjedhin njërën nga tre disiplinat e posaçme: gjuhësi; letërsi dhe histori-civilizim, vlerësuar me 40 pikë. Programi hartohet nga personeli akademik i departamentit dhe miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit, për t’ju bërë i ditur më pas studentëve që të mund të orientohen tek fushat e përzgjedhura. Provimi përfundimtar organizohet me gojë dhe me shkrim. (Ref. 3.11 Rregullore e mikrotezes dhe provimit te diplomimit; Ref. 1.7 R.regullore e FSHH-se, Ref. 1.8 Rregullore e programit te studimit; Ref. 1.14 Rregullore e Departamentit).</p> <p>GVJ vëren se rregullorja e programit të studimit dhe rregullorja e mikrotezës dhe diplomimit duhet të përmbajnë parashikime, të cilat lidhen më ngushtësisht me modalitetet e diplomimit në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, si numri i anëtarëve të komisionit të mbrojtjes së diplomës, të dhëna të detajuara për provimin e përgjithshëm përfundimtar, procedurën e organizimit (me shkrim/me gojë) dhe vlerësimin në rastin e provimit të përgjithshëm. Gjithashtu, rekomandohet nga GVJ të përcaktohet pesha specifike e vlerësimin sipas ndarjes provim me gojë /me shkrim dhe afati i bërjes publike të kriterëve të diplomimit për studentët.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton</p>	<p>GVJ konstaton nga shqyrtimi i materialeve në DVV dhe referuar vizitës në institucion, se në rastin e përzgjedhjes së mbrojtjes me temë diplomë, studenti asistohet nga udhëheqësi nëpërmjet grafikut të konsultave për punimin e diplomës. Udhëheqësi i diplomës harton programin e punës, duke përcaktuar afate të përafërta për realizimin e tij. Para mbrojtjes së diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti, në kushtet kur plotëson udhëzimet për punimin e diplomës. Të tillë udhëzues janë parashikuar në rregulloren e studimeve të UE-së, si edhe në rregulloren e mikrotezës dhe provimit të diplomës për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” (Ref. 3.11 Rregullore e mikrotezes dhe provimit te diplomimit ; Ref. 1.2 Rregullore e Studimeve te Uniel, Neni 62/63).</p>

<p>cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>GVJ mbështetur në RVB, dokumentacionin shoqërues të tij dhe në vizitën në institucion konstaton se DGJH vë në dispozicion të punës shkencore dhe kërkimore me karakter praktik, labororet e teknologjisë së informacionit, të cilat studentët mund ti shfrytëzojnë për analizën e të dhënave lidhur me përgatitjen e temave të diplomave. GVJ konstaton se Departamenti i Gjuhëve të Huaja, ju ofron mundësinë të gjithë studentëve të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë angleze", shfrytëzimin e fondit të Bibliotekës, si fizike dhe atë digjitale në ambjentet e UE-së ose të laboratorëve në funksion të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" (Ref.1.2 Rregullore e Studimeve te Uniel; Ref.1.7 Rregullore e FSHH-se; Ref.1.8 Rregullore e programit te studimit; Ref.1.14 Rregullore e Departamentit; Ref. 3. I I Rregullore e mikrotezes dhe provimit te diplomimit; Ref.3.21 Të dhënat për bibliotekën.pdf Ref.3.20 Blerjet e fundit të Bibliotekës.pdf Ref.3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library)</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e paraqitur në DVV, konstatohet nga GVJ se provimi përfundimtar vlerësohet me notë nga 1-10, ku 5 është nota kaluese për t'u diplomuar. Studenti hyn në provim diplome pasi ka përmbushur të gjitha detyrimet akademike, plotësimin e krediteve për çdo lëndë që përmban program i studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze". Diplomimi mbart kreditet e përcaktuara në planin mësimor, (6) ECTS. Sistemi i vlerësimit me notë është shpërndarë sipas sistemit të pikëzimit të përcaktuar për mbrojtjen me temë diplome dhe të provimit të përgjithshëm. GVJ konstaton se mënyra e vlerësimit me temë diplome ndahet në 7 rubrika, me vlerësime që variojnë nga 5 -30 pikë, dhe në total janë 100 pikë. Ndërsa përsa i përket provimit të përgjithshëm, studentët kanë një format të përbashkët, ku përfshihen seksionet: përkthim; e folur; e shkruar; gjuhë praktike, në total e vlerësuar me 60 pikë. Në seksionin e dytë, provimi i përgjithshëm u jep të drejtën studentëve të zgjedhin njëri nga tre disiplina specifike: gjuhësi, letërsi dhe histori-civilizim, e vlerësuar me 40 pikë, në total 100 pikë. Këto forma vlerësimi në diplomimin e studentëve në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze", nuk parashikojnë mesataren e notave të tre viteve të studimeve. (Ref. 3.11 Rregullore e mikrotezes dhe provimit te diplomimit). GVJ konstaton se në përfundim të procesit të provimit, Kryetari i Komisionit të provimit hedh rezultatet e vlerësimit në Sistemin elektronik të menaxhimit të të dhënave. Procesverbali i gjeneruar nga sistemi elektronik i menaxhimit të të dhënave, nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të provimit të përgjithshëm përfundimtar, ndërsa në rastin e mbrojtjes me temë diplome shpallja e vlerësimit bëhet nga kryetari në prani të kandidatit dhe të të gjithë</p>

	<p>komisionit. GVJ konstaton se në përfundim të procesit, Kryetari i Komisionit hedh rezultatin e vlerësimit në Sistemin elektronik të menaxhimit të të dhënave. Procesverbali i gjeneruar nga sistemi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të provimit të përgjithshëm përfundimtar (Ref.1.2 Rregullore e Studimeve te Uniel/ Neni 62/63; Ref.1.7 Rregullore e FSHH-se; Ref. 1.8 Rregullore e programit te studimit), Ref.1.14 Rregullore e Departamentit; Ref.3.11 Rregullore e mikrotezes dhe provimit te diplomimit).</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>GVJ konstaton nga dokumentacioni në DVV dhe nga vizita në institucion, se pasi studentët kanë shlyer të gjitha detyrimet e programit Bachelor në Gjuhë Angleze, përfshirë detyrimet financiare apo materiale kundrejt universitetit, pajisen me diplomë dhe suplementin e saj, të miratuar me vendim Senati Nr. 18, dt. 22.07.2021 në përputhje me udhëzimin Nr. 10.dt. 30.3.2020 e MAS (Ref.1.31 Miratimi i përmbajtjes dhe formës së diplomës nga UNIEL.pdf 3.12 Modeli i suplementit të diplomës të programit të studimit “Bachelor në gjuhë angleze”.pdf) Në përfundim të studimeve, me kërkesë të studentit, atij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, e cila parashikohet në Rregulloren e UE-së (Ref.1.2 Rregullore e Studimeve te Uniel).</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Mbështetur në infomacionin në RVB dhe dokumentacionin e paraqitur në DVV, si edhe në vizitën në institucion, GVJ konstaton se UE nëpërmjet strukturës së sekretarisë mësimore të FSHH, parashikon në Nenin 9 të rregullores së organizimit dhe funksionimit, rolin e sekretari-arkivit të kësaj strukture, e cila administron dokumentacionin e procesit mësimor. GVJ konstaton se sekretaria mësimore e UE-së disponon në formatin fizik: regjistrin themeltar të studentëve me të dhënat personale; regjistrin e arritjeve akademike të studentëve me vlerësimin e tyre (me notë dhe fjalë) dhe regjistrin për lëshimin e diplomave dhe çertifikatave të studentëve (numri i diplomës, datën e diplomimit dhe datën e tërheqjes së diplomës dhe Suplementit të diplomës). (Ref. 5.26. Udhëzim nr 16-dt. 08.07.2019 `Për pajisjen e IAL-ve me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike, regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave; Ref. 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL).</p> <p>GVJ konstaton se regjistri themeltar rezultoi plotësuar me shkrim dore pa korigjime, nuk ndryshon për asnjë arsye dhe ruhet për periudhë të pacaktuar kohore në formë fizike. Përpunimi dhe administrimi i të dhënave personale të studentëve bëhet nga ana e sekretarisë mësimore në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri. GVJ konstaton se sekretaria mësimore ka akses në sistemin elektronik EMS në funksion të gjenerimit dhe përditësimit të të dhënave të</p>

	studentëve, si dhe monitorimit të tyre (Ref.1.16 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHH-së).
Konkluzione	<p>GVJ, referuar "Rregullores së mikrotezës dhe provimit të diplomimit", konstaton se diplomimi i studentëve në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" bëhet me provim përfundimtar të diplomimit dhe me temë diplome, për studentët me mesatare 7.5 në dy vitet e para të studimit. GVJ konstaton se sipas Rregullores FSHH dhe Rregullores UNIEL, studenti ka të drejtë të mbrojë me temë diolome në rast se ka mesataren e dy viteve të para jo më pak se nota (8). Referuar rregullores së studimeve UNIEL, për administrimin e provimit final të formimit ngrihet një komision i posaçëm me propozim të Departamentit të Gjuhëve të Huaja, i cili më pas miratohet në Dekanat. Ky komision është i përbërë nga personel akademik 3-5 anëtarë në rastin e provimit përfundimtar të diplomimit, ndërsa për mbrojtjen me temë diplome ngrihet një komision me jo më pak se 5 anëtarë, i cili është i angazhuar në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze". Mbështetur në dokumentacionin e paraqitur në DVV, konstatohet nga GVJ se provimi përfundimtar vlerësohet me notë nga 1-10, ku 5 është nota kaluese për t'u diplomuar. Studenti hyn në provim diplome pasi ka përmbushur të gjitha detyrimet akademike, plotësimin e krediteve për çdo lëndë që përmban programi i studimit. Diplomimi mbart kreditet e përcaktuara në planin mësimor (6 Kredite). Sistemi i vlerësimit me notë është shpërndarë sipas sistemit të pikëzimit të përcaktuar për mbrojtjen me temë diplome në Rregulloren e Mikrotezës (7 rubrika vlerësimi të cilat variojnë nga 5 pikë deri në 30. GVJ konstaton se në provimin e formimit të diplomimit, ka dy seksione: pjesa e përgjithshme dhe e përbashkët për të gjithë studentët (60 pikë) dhe seksioni specifik (40 pikë), i cili përzgjidhet nga vetë studenti. GVJ konstaton nga dokumentacioni në DVV dhe nga vizita në institucion se pasi studentët kanë shlyer të gjitha detyrimet e programit Bachelor në "Gjuhë Angleze", përfshirë detyrimet financiare apo materiale kundrejt universitetit, pajisen me diplomë dhe suplementin e saj, të miratuar me vendim Senati Nr. 18, dt 22.07.2021 në përputhje me udhëzimin Nr 10.dt. 30.3.2020 e MAS. GVJ konstaton se UE nëpërmjet strukturës së sekretarisë mësimore të FSHH, parashikon në Nenin 9 të rregullores së organizimit dhe funksionimit të UE-së rolin e sekretari-arkivit të kësaj strukture, e cila administron dokumentacionin e procesit mësimor. GVJ konstaton se sekretaria mësimore e UE-së disponon në formatin fizik: regjistrin themeltar të studentëve me të dhënat personale; regjistrin e arritjeve akademike të studentëve me vlerësimin e tyre (me notë dhe fjalë) dhe regjistrin për lëshimin e diplomave dhe çertifikatave të studentëve (numri i diplomës, datën e diplomimit dhe datën e tërheqjes së diplomës dhe Suplementit të diplomës). GVJ rekomandon që pragu i mesatares së notës, të përfshihet në rregulloren e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze. GVJ pavarësisht se evidenton që UE ka përfshirë qartësisht procedurën e</p>


	<p><i>diplomimit në rregulloret në nivel universiteti dhe në nivel të FSHH-së, GVJ rekomandon që DGHJ/Dekanati i FSHH duhet të hartojë dhe miratojë rregullore të posaçme për diplomimin. Rregullorja e mikrotezës për programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" paraqitur në DVV ka formën e Manualit të punimit të mikrotezës dhe pjesa rregullatore është shtojcë e tij, është e pamiraturar në Dekanat dhe nuk përmban detaje mbi njoftimin e studentëve për afatet e diplomimit; përbërjen e Komisionit të diplomimit; modalitetet e zhvillimit provimit final, (shkrim/me gojë ose me shkrim dhe me gojë), si dhe procedurën e vlerësimit për seksionet e mësipërme.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
		X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
<p>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar tek dokumentacioni plotësues përcjellë përmes DVV dhe shqyrtimi i CV të PAE, GVJ konstaton se personeli akademik që jep mësim në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" i përmbush kriteret dhe kualifikimet e përcaktuara në aktet ligjore në fuqi. Institucioni siguron mbështetje të vazhdueshme për kualifikimin dhe ngritjen profesionale të personelit akademik, çka përcaktohet si përparësi edhe në strategjinë e zhvillimit institucional të UE dhe të njësisë kryesore [Ref. 1.7 Strategjia e UNIEL; Ref. 1.17 Strategjia e zhvillimit të FSHH-së]</p> <p>Gjatë takimeve të zhvilluara nga ekspertët e GVJ me drejtuesit e fakultetit dhe personelin akademik, u ritheksua fakti se mbështetja e institucionit ishte konkrete dhe reflektohej në nxitjen dhe përkrahjen që u jepej pedagogëve përmes programeve të shkëmbimit Erasmus +, Bursave Fulbright etj. [Ref. 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+; Ref. 3.2 Të dhëna mbi mobilitetin e personelit]</p>

<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar te dokumentacioni i paraqitur në DVV, GVJ konstaton se njësia bazë sigurohet që të ketë parashikuar qartë shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me kërkesat e programit mësimor, bazën ligjore që rregullon ngarkesën minimale dhe maksimale dhe kualifikimet e stafit akademik. [Ref. 1.1 Statuti i UNIEL]. Referuar të njëjtave burime vërehet se PAE i angazhuar në këtë program studimi e mbulon ngarkesën mësimore të zhvilluar në masën 100%. DGJH merr përsipër organizimin sa më efektiv të procesit mësimor. Ngarkesa mësimore dhe orari mësimor përcillen zyrtarisht në Dekanat dhe Rektorat.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Dokumentacioni plotësues i përfshirë në DVV jep të dhëna mbi faktin se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë angleze” është punësuar mbi bazën e të gjithë kriterëve dhe zotëron të gjithë dokumentacionin e nevojshëm mbështetur në legjislacionin në fuqi. [Ref. 3.1 Listëpagesa e personelit janar-qershor 2022]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar tek informacioni i dhënë në DVV, Drejtoria e Burimeve Njerëzore është struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Gjuhën Angleze”. Ngritja dhe funksionimi i kësaj strukture bazohet në nenet 64, 65 të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe bazës ligjore të IAL. Kjo njësi administron dokumentacionin dhe procedurat e ndjekura për rekrutimin e personelit akademik. [Ref 4.2 Rregullore e modaliteteve te rekrutimit te personelit akademik UNIEL; Ref 4.3 Rregullore e modaliteteve te rekrutimit te personelit ndihmëskadematik; Ref 4.4 Rregullore e rekrutimit te personelit administrativ]</p> <p>GVJ konstaton se njësia bazë përcakton dhe harton procedurat dhe kriteret e veçanta për rekrutimin e personelit duke pasur parasysh nevojat e programit, specifikat e tij dhe kriteret e vendit të punës. Dekani i FSHH-së i përcjell me shkresë Rektorit, i cili është autoriteti vendimmarrës, dosjen me dokumentacionin e lartpërmendur. Vlerësimi i kandidatëve kryhet nga një komision Ad Hoc.[Ref 1.1 Statuti i UNIEL, kreu III, neni 22; Ref.1.14 Rregullore e departamentit, neni 5, 6]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të</p>	<p>Referuar dokumentacionit të paraqitur, vlerësohet se pranë DGJH është angazhuar një personel ndihmësakadematik, me funksionin laborant, i cili merr përsipër mirëmbajtjen e pajisjeve mësimore, kompjuterave të laboratorit të gjuhëve të huaja, pajisjeve të laboratorit të përkthimit,</p>



<p>mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>tabelës inteligjente, projektorëve, setit të video-konferencave etj. [Ref. 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit të Shkencave Humane; Ref. 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve të Fakultetit të Shkencave Humane]</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Bazuar tek informacioni i dhënë në Dosjen e Vlerësimit të Brendshëm, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës siguron, mbron dhe përditëson të dhënat mbi personelin akademik. Kjo strukturë është organizuar në nivel institucional dhe administron çdo vit dosjet e personelit akademik, ndihmësakademik për çdo program studimi të UNIEL. Nga shqyrtimi i dosjeve të personelit akademik, GVJ konstaton se ato përmbanin të gjithë dokumentacionin e nevojshëm nisur nga të dhënat personale e më pas të dhëna mbi kualifikimet e tyre të përditësuara në mënyrë periodike, si dhe kontratën e punës. [Ref 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL, kreu II, neni 16)</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar informacionit të përcjellë, GVJ konstaton se pranë IAL është ngritur Bordi Këshillimor i Biznesit përmes së cilit krijohet mundësia që studentët të informohen mbi kërkesat e tregut të punës dhe nevojat e punëdhënësve. Sipas informacionit të përcjellë përmes RVB, njësia bazë organizon veprimtari ekstra kurrikulare në funksion të procesit mësimor ndër të cilat edhe vizita vëzhguese pranë institucioneve apo bizneseve private. <i>GVJ konstaton mungesën e praktikës profesionale që nuk është përfshirë si veprimtari brenda kuadrit të lëndëve të kategorisë D. GVJ gjykon se dokumentacioni i përcjellë përmes DVV, nuk përmban të dhëna konkrete mbi marrëveshjet e arrira apo mënyrën se si kryhet ky lloj bashkëpunimi dhe vëren mungesën e të dhënave mbi llojin, natyrën dhe mënyrën se si realizohen këto veprimtari.</i> [Ref. 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit]</p>
<p>Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet</p>	<p>N/A</p>



<p>të ndihmojë studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>				
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se personeli akademik që jep mësim në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” i përbush kriteret dhe kualifikimet e përcaktuara në aktet ligjore në fuqi. Mbështetja e institucionit për kërkimin shkencor të personelit akademik është konkrete dhe reflektohet me përkrahjen që u jepej pedagogëve përmes programeve të shkëmbimit Erasmus +, Bursave Fulbright etj. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë angleze” është punësuar mbi bazën e të gjithë kriterëve dhe zotëron të gjithë dokumentacionin e nevojshëm mbështetur në legjislacionin në fuqi. Shpërndarja e ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me kërkesat e programit mësimor, bazën ligjore dhe kualifikimet e stafit akademik. Ngritja e Bordit Këshillimor të Biznesit krijon mundësinë e informimit mbi kërkesat e tregut të punës. GVJ konstaton mungësën e praktikës profesionale që nuk është përfshirë si veprimtari brenda kuadrit të lëndëve të kategorisë D dhe vëren se megjithëse në informacionin e përcjellë përmes RVB theksohet se njësisia bazë organizon veprimtari ekstra kurrikulare në funksion të procesit mësimor ndër të cilat edhe vizita vëzhguese pranë institucioneve apo bizneseve private, dokumentacioni i përfshirë në DVV, nuk përmban të dhëna konkrete mbi marrëveshjet e arritura apo mënyrën se si kryhet ky lloj bashkëpunimi sikundër dhe vëren mungesën e të dhënave mbi llojin, natyrën dhe mënyrën se si realizohen këto veprimtari.</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	


<p>Standardi IV.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në</p>	<p>Procesi mësimor për studentët e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” kryhet në mjedise të posaçme të vendosura në diapozicion nga FSHH-ja. Bazuar tek materiali i vënë në dispozicion nga GVB dhe pas vizitave dhe vëzhgimeve të kryera në mjediset e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>institucionit, GVJ konstatoi se në përmbushje të nevojave dhe në funksion të procesit mësimor, studentët e këtij programi studimi shfrytëzojnë tre auditorë leksionesh të pajisur me videoprojektorë dhe videokonferencë dhe tre salla seminaresh të pajisur me kompjutera dhe videoprojektorë. Laboratori i përkthim- interpretimeve ofron mundësinë e përdorimit të tabelave inteligjente interaktive dhe pajisjeve elektronike për realizimin e përkthimit simultan. [Ref. 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidencë 4.7 Të dhëna mbi kapacitetin dhe infrastrukturën e Laboratorëve të Fakultetit].</p> <p>Gjatë takimeve të zhvilluara në institucion, GVJ vizitoi mjediset e një biblioteke të vënë në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” ku vëzhgoi nga afër fondin fizik të librave të ofruar në gjuhën angleze. Gjithashtu GVJ konstatoi se studentëve të këtij programi studimi u ishin ofruar edhe një numër i konsiderueshëm librashë në formatin digjital. [Ref. 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidencë 4.7 Të dhëna mbi kapacitetin dhe infrastrukturën e Laboratorëve të Fakultetit]</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, vizitës në mjediset e fakultetit dhe bashkëbisedimit me personelin akademik dhe studentët u vlerësua fakti se pajisjet elektorinike dhe të teknologjisë së informacionit vihen në dispozicion të procesit mësimor. Gjatë takimit të realizuar nga GVJ, studentët pohuan se pajisjet dhe programet softëare të instaluar ishin aktive dhe i shërbenin në mënyrë frutdhënëse veprimtarisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjatë bisedave të zhvilluara me stafin akademik, pedagogët rikonfirmuan faktin se institucioni organizon trajnime dhe përditësime për të rejtat e teknologjisë në bashkëpunim edhe me institucione të tjera. [Ref. 4.20 Përshkrim i laboratorëve dhe sallave me mjete teknike në shërbim të departamentit]</p> <p>Gjithë personeli akademik dhe studentët janë të pajisur me adresë email-i zyrtare dhe kanë llogarinë e tyre në platformën Microsoft Teams. [Ref. 6.1 Guida e pedagogut: Mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams]</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë</p>	<p>Pasi shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVV, GVJ vizitoi nga afër mjediset e FSHH-ne, nga ku konstatoi se sallat e laboratorëve dhe auditorët e leksioneve janë të pajisura me pajisjet e duhura për kryerjen e një procesi mësimor bashkëkohor dhe janë në</p>



aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	funksion të përmbushjes së nevojave dhe kërkesave të studentëve të këtij programi studimi. Studentët pohuan gjatë takimeve me ta, se në disa lëndë me natyrë specifike si Përkthim- Interpretim, Gjuhë praktike angleze, Fonetikë dhe Fonologji, Anglishte e folur dhe e shkruar, këto mundësi shfrytëzoheshin maksimalisht.[Ref. 4.20 Përshkrim i laboratorëve dhe sallave me mjete teknike në shërbim të departamentit]		
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	GVJ vizitoi nga afër laboratorët e vënë në dispozicion të DGJH-së, të cilët janë të lidhur me internet dhe përmes një rrjeti komunikimi qëndror sigurojnë zhvillimin e aftësive komunikuese të studentëve. Pajisjet e vëna në funksion të laboratorit të Përkthim-Interpretimit përdoren për përkthimin simultan. [Ref. 4.20 Përshkrim i laboratorëve dhe sallave me mjete teknike në shërbim të departamentit]		
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se në funksion të veprimtarisë mësimore të këtij programi studimi shfrytëzohen tre auditorë leksionesh, tre salla seminaresh, një laborator i përkthim- interpretimeve dhe dy salla bibliotekash. Laboratorët e vënë në dispozicion të DGJH-së, janë të lidhur me internet dhe përmes një rrjeti komunikimi qëndror sigurojnë zhvillimin e aftësive komunikuese të studentëve. Sallat e laboratorëve dhe auditorët e leksioneve janë të pajisura me mjetet e duhura për kryerjen e një procesi mësimor bashkëkohor dhe janë në funksion të përmbushjes së nevojave dhe kërkesave të studentëve të këtij programi studimi. Institucioni organizon trajnime dhe përditësime për të rejat e teknologjisë në bashkëpunim edhe me institucione të tjera. Personeli akademik dhe studentët janë të pajisur me adresë email-i zyrtare dhe kanë llogaritë e tyre në platformën Microsoft Teams.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit	Gjatë vizitës në mjediset e bibliotekave të FSHH-së, shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe nga bashkëbisedimi me studentët e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, GVJ konstatoi se studentët dhe personeli akademik i këtij programi

<p>(fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>shfrytëzon mjediset e bibliotekës së UNIEL sikurse dhe burime literature të siguruara përmes anëtarësimit në JSTORE dhe U-Library. [Ref. 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit]</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Referuar takimeve me punonjësin e bibliotekës dhe drejtuesve të njësisë bazë dhe asaj kryesore u theksua fakti se DGJH shpreh kërkesat për pasurimin e bibliotekës me literaturë të përditësuar. Pasi shqyrtoi programet lëndore dhe literaturën e rekomanduar për shfrytëzim, GVJ konstaton se këto burime nuk ishin të përditësuar me botime të 5 vjetëve të fundit. [Ref. 3.8 Fondi i librit; Ref. 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL, kreu II, neni 17]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në mjediset e bibliotekave të FSHH-së, shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe nga bashkëbisedimi me studentët e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, GVJ konstatoi se studentët dhe personeli akademik i këtij programi shfrytëzojnë dy salla bibliotekash, atë qendrore dhe bibliotekën e DGJH-së e cila siguron një fond të pasur titujsh, kryesisht në formatin digjital. [Ref. 3.8 Fondi i librit; Ref. 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL, kreu II, neni 17; Ref. 3.13 Raport për fondin e bibliotekës së programit të studimit].</p> <p>Studentëve gjithashtu u sygjerohet dhe u ofrohet mundësia e përdorimit pa pagesë dhe pa limit të bibliotekës online, sikurse dhe një platformë online (Rosseta Stone) për mësimin e gjuhëve të huaja. [Ref. 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library]</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, vizitës në mjediset e bibliotekave dhe bashkëbisedimit me personel akademik dhe studentë rezultoi se bibliotekat e FSHH-së ofrojnë një fond të pasur librash në gjuhësi, histori, letërsi, përkthim, qytetërim, metodologji etj. GVJ vëzhgoi nga afër fondin e bibliotekës së departamentit me rreth 1000 tituj fizik dhe digjitalë. [Ref 3.13 Raport për fondin e bibliotekës së programit të studimit]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të</p>	<p>Gjatë takimeve institucionale me përfaqësues të studentëve të programit të studimit, këta të fundit ritheksuan faktin se shërbimet e bibliotekave ishin efikase dhe burimet e ofruara ishin lehtësisht të aksesueshme prej tyre.</p>

studimit.	
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	GVJ konstatoi pas vizitës në institucion se bibliotekat ishin të pajisura me kompjuter, videoprojektorë, printera dhe fotokopje. Biblioteka e departamentit disponon edhe një pajisje Kindle për leximin e materialeve në formatin digjital. [Ref. 3.13 Raport për fondin e bibliotekës së programit të studimit].
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Gjatë takimit në mjediset e bibliotekës, personeli përgjegjës theksoi edhe një herë orarin e funksionimit të bibliotekës, kapacitetin maksimal të shfrytëzimit me 309 vende leximi dhe faktin se ky orar kufizohet vetëm në rastet kur mjediset e saj shfrytëzohen në mbështetje të procesit mësimor, trajnimeve apo veprimtarive të tjera të institucionit. [Ref. 4.10 Të dhëna mbi orarin e shërbimit të Bibliotekës UNIEL]. Bibliotekat online funksionojnë me një shërbim 24/7. Gjatë vizitës, GVJ konstatoi se kapaciteti i bibliotekës së DGJH-së ishte 24 vende leximi të cilat shfrytëzoheshin maksimalisht nga studentët e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” [Ref. 3.13 Raport për fondin e bibliotekës së programit të studimit].
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Institucioni, në bashkëpunim me stafin e bibliotekës, personelin akademik dhe studentët e programit, planifikon në mënyrë periodike shtimin e fondit të librave me tituj të rinj. Pas shqyrtimit të analizës vjetore të IAL-së, GVJ konstatoi se një nga prioritetet e institucionit është shtimi i literaturës profesionale dhe shkencore. Sipas dokumentacionit të përcjellë, projekti CleanScore ka siguruar anëtarësimin e UNIEL në bibliotekën digjirtale JSTORE. Gjithashtu falë një projekti fitues me buxhet të financuar nga AKKSH-i ka filluar procesi i digjitalizimit të burimeve të bibliotekës. [Ref 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021]. Informacioni i dhënë në DVV dhe bisedat pranë institucionit, theksojnë faktin se për shkak të natyrës specifike të teksteve në gjuhën angleze, sigurimi i tyre bëhet me vështirësi dhe për këtë arsye vihen re edhe mungesa.
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se studentët dhe personeli akademik i këtij programi shfrytëzojnë dy salla bibliotekash, atë qendrore dhe bibliotekën e DGJH e cila siguron një fond të pasur titujsh, kryesisht në formatin digjital. Kapaciteti maksimal i shfrytëzimit të mjedisëve të bibliotekave është 309 vende leximi. Bibliotekat e FSHH-së ofrojnë një fond të pasur librash në gjuhësi, histori, letërsi, përkthim, qytetërim, metodologji Burime literature janë siguruar edhe përmes</i>

	<p>anëtarësimin në JSTORE dhe U-Library. Studentëve u është ofruar mundësia e përdorimit pa pagesë dhe pa limit të bibliotës online, sikurse dhe një platformë online (Rosseta Stone) për mësimin e gjuhëve të huaja.. GVJ shqyrtoi programet lëndore dhe literaturën e rekomanduar për shfrytëzim nga ku rezultoi se këto burime nuk ishin të përditësuar me botime të 5 vjetëve të fundit. Gjatë takimeve në institucion u theksua se një nga prioritetet e institucionit është shtimi i literaturës profesionale dhe shkencore me tituj të rinj, por gjithashtu u konstatua se për shkak të natyrës specifike të teksteve në gjuhën angleze, sigurimi i tyre bëhet me vështirësi dhe për këtë arsye vihen re edhe mungesa.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Dokumentacioni i plotësuar nga GVV përcakton qartë se në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktara në ligjin LAL 80/2015 dhe Statutin e UNIEL, neni 70, FSHH-ja ka detyrimin të ruajë dhe të administrojë informacionin e lidhur me studentët, që nga regjistrimi e deri në diplomimin e tyre. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ verifikoi regjistrin themeltar të studentëve; regjistrin e arritjeve akademike; regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.</p> <p>GVJ konstatoi se sekretaria mësimore administrojnë të dhënat e studentëve, përpunon dhe arkivon procesverbalet dhe dokumentacione të tjera lidhur me cilësinë akademike të studentëve sikurse plotëson dhe certifikon suplementin e diplomës. [Ref 1.16 Modaliteti i organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHH].</p> <p>GVJ konstatoi gjithashtu se një sistem elektronik i vënë në përdorim shërben për koordinimin e proceseve mësimore dhe administrative dhe shkëmbimin e informacionit me studentët. [Ref 4.11 Rregullorja EMS]</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe</p>	<p>Informacioni dhe dokumentacioni i veprimtarisë së personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ ruhet dhe administrohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës. Njësia bazë, DGJH, gjithashtu ruan dhe dokumenton</p>

<p>aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>informacion fizik dhe elektronik për stafin akademik dhe e përditëson periodikisht atë. [Ref. 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL kreu II, neni 16]</p> <p>Bazuar tek dokumentacioni plotësues i DVV dhe verifikimeve të kryera gjatë vizitave në institucion, GVJ vlerëson se studentët dhe stafi akademik mund të sigurojnë dhe të aksesojnë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, nëpërmjet faqeve Ëeb të UNIEL apo dhe strukturave të tjera siç është Dekanati, sekretaria mësimore etj. [Ref. 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB]</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sipas të dhënave të paraqitura në DVV, personeli akademik dhe studentët e UNIEL komunikojnë dhe shkëmbejnë informacion përmes platformës Microsoft Teams dhe llogarive zyrtare uniel.edu.al [Ref. 6.1 Guida e pedagogut: Mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams]</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV rezulton se sistemi i menaxhimit të informacionit sipas sektorëve të ndryshëm është aktiv dhe ofron informacion për veprimtarinë akademike dhe administrative në kohë reale. Gjatë vizitës në institucion, GVJ-së ju konfirmua nga personeli akademik dhe ndihmës akademik se sistemi i menaxhimit të informacionit në rang njësie kryesore dhe njësie bazë, u mundësonte drejtuesve dhe titullarëve të institucionit komunikim të shpejtë dhe efikas.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Pas verifikimeve të kryera, GVJ konstatoi se faqja e internetit të institucionit përmban informacion të zgjeruar, të përditësuar dhe lehtësisht të aksesueshëm. Të dhënat mbi programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze përfshijnë planin mësimor (në gjuhën shqipe), CV e personelit akademik, veprimtaritë e zhvilluara etj. [Ref. 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ verifikoi regjistrin themeltar të studentëve; regjistrin e arritjeve akademike; regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave dhe konstatoi se sekretaria mësimore administron, përpunon dhe arkivon të dhënat, procesverbalet dhe dokumentacione të tjera lidhur me cilësinë akademike të studentëve. Sistemi i menaxhimit të informacionit është aktiv dhe efikas dhe u mundëson drejtuesve dhe titullarëve të institucionit komunikim të shpejtë në rrang njësie kryesore dhe njësie bazë. Informacioni dhe dokumentacioni i veprimtarisë së personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ ruhet dhe administrohet nga Sektori i Burimeve</i></p>

	<i>Njerëzore dhe Protokoll Arkivës. Faqja e internetit të institucionit rezulton të jetë e përditësuar dhe lehtësisht e aksesueshme. Të dhënat mbi programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" përfshijnë planin mësimor (në gjuhën shqipe), CV e personelit akademik dhe veprimtaritë e zhvilluara</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të paraqitur në DVV, në fillim të çdo viti akademik, IAL harton dhe paraqet raportin vjetor në të cilin përfshihet analiza e realizimit të buxhetit financiar, raportimin vjetor për kryerjen e veprimtarive, gjendjen financiare të universitetit, parashikimin e ngarkesës së personelit akademik, tarifat e studimit dhe parashikimin për vitin pasardhës. Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit janë dy organet përgjegjëse për shqyrtimin dhe miratimin e këtyre planeve. [Ref. I. I Statuti i UNIEL, kreu 42]</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të</p>	<p>Referuar DVV, parashikimi i kostove të shpenzimeve të përlogaritura, që lidhen kryesisht me pagesat për burimet njerëzore, pajisje, investime apo shërbime nuk planifikohen nga njësi bazë por nga vetë institucioni. Si rregull kostot e programit përcaktohen në momentin e hapjes së programit të studimit. Kostot e tjera si financimi për kërkimin shkencor, mbështetja për burimet njerëzore, investimet në logjistikë, teknologji dhe infrastrukturë planifikohen në fillim të çdo viti akademik. Buxheti miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit</p> <p>[Ref. 4.16 Të dhëna që lidhen me koston e programit të studimit, plani për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi; Ref. 4.14 Miratimi i Buxhetit 2022]</p>

tjerë.	
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se auditimi i brendshëm periodik i gjendjes financiare kryhet nga institucioni bazuar në Ligjin nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” [Ref .4.14 Miratimi i Buxhetit 2022] Bashkëngjitur me dokumentacionin e paraqitur në DVV, është përfshirë analiza e realizimit të buxhetit financiar dhe detajimi i planit të buxhetit financiar për vitin 2022. Raporti i detajuar certifikohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të Universitetit dhe kontrollohet nga Ministria e Financave, bazuar në LAL 80/2015, neni 116, pika 2. [Ref. 4.13 Raporti i Auditit KLSH 2022]
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Bazuar tek rregullorja e organizimit të UNIEL dhe analiza vjetore e institucionit 2021-2022, të përcjella përmes DVV, GVJ konstatoi se propozimet e bëra nga njësia bazë, reflektohen në projekt buxhetin e hartuar nga institucioni. Raporti mbi veprimtarinë financiare të IAL analizohet në Senatin Akademik. [Ref. 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL, kreu III, neni 21;Ref 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021, f. 98-115]
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Institucioni financohet nga buxheti i shtetit dhe administron fondet e veta financiare. UNIEL i harton planet buxhetorë vjetorë në përputhje me kërkesat, nevojat dhe planin strategjik të zhvillimit të këtij institucioni. Parashikimet e planeve buxhetorë mbajnë parasysh prioritetet e institucionit dhe synojnë të sigurojnë një qëndrueshmëri të vazhdueshme financiare. [Ref. 4.14 Miratimi i buxhetit 2022; Ref 4.15 Miratimi i regjistrit të prokurimeve dhe shërbimeve]
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se në fillim të çdo viti akademik, IAL-ja harton dhe paraqet raportin vjetor në të cilin përfshihet analiza e realizimit të buxhetit financiar, raportimi vjetor për kryerjen e veprimtarive dhe parashikimi për vitin pasardhës. Parashikimi i kostove të shpenzimeve të përlllogaritura, që lidhen kryesisht me pagesat për burimet njerëzore, pajisje, investime apo shërbime nuk planifikohen nga njësia bazë por nga vetë institucioni Propozimet e bëra nga njësia bazë, reflektohen në projektbuxhetin e hartuar nga institucioni. UNIEL i harton planet buxhetorë vjetorë në përputhje me kërkesat, nevojat dhe planin strategjik të zhvillimit të këtij institucioni. Parashikimet e</i>

	<i>planeve buxhetore mbajne parasysh prioritetet e institucionit dhe synojne te sigurojne nje qendrueshmeri te vazhdueshme financiare.</i>			
Shkalla e permbushjes se standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e permbushjes se standardeve te fushes IV	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit te larte harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura per pranimin, perzgjedhjen, perparimin e studenteve, transferimin, njohjen, vleresimin e dijeve dhe diplomimin ne programin e studimit.	
Kriteret	Vleresimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura qe mbulojne ciklin e plotë akademik te studenteve nga hyrja ne dalje, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar ne dokumentacionin e paraqitur per shqyrtim nga GVB, GVJ konstaton se hartimi i programeve te studimit te ciklit te pare, ku perfshihet edhe programi Bachelor ne "Gjuhë Angleze" kryhet ne perputhje dhe procedurat e parashikuara ne ligjin nr.80/2015 si dhe me aktet rregullatore ne fuqi. Zyra e Keshillimit te Karrieres dhe Alumni eshte struktura pergjegjese institucionale qe bashkerendon marrdheniet me studentet qe nga momenti i regjistrimit te tyre e deri ne diplomim. Detyrat, funksionet dhe pergjegjesite e kesaj zyre mbeshteten ne rregulloren e Universitetit dhe rregulloren e Zyres se Karrieres dhe Alumni. Përveç kesaj strukture, informimi i studenteve dhe sigurimi i marrdhenieve me studentet kryhet edhe nga njësia kryesore(FSHH) dhe njësia bazë(DGJH) [Ref 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit te UNIEL; Ref. 1.7 Rregullore e FSHH; Ref. 5.9 Urdhri per Komisionet e perhershme institucionale ne Uniel; Ref. 5.9 Urdhri per Komisionet e perhershme institucionale ne Fakultet; Ref. 5.17 Rregullore per funksionimin e komisionit te perhershem per studentet dhe keshillimin e karrieres]
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja ne dalje garantojne barazine dhe te drejta te njajta per te gjithë kandidatet per studente dhe	Pranimi i studenteve ne programin e studimit Bachelor ne "Gjuhën angleze" kryhet sipas procedurave dhe kriterëve te bazuara ne legjislacionin ne fuqi duke garantuar barazi gjinore dhe fetare dhe te drejta te barabarta per te gjithë kandidatet per student. Ato mbeshteten


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

studentët e programit të studimit.	në rregulloren e institucionit, njësisë kryesore dhe njësisë bazë.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Dokumentacioni mbështetës i vënë në dispozicion për GVJ, sqaron mënyrën e përcaktimit të kriterëve së përzgjedhjes së kandidatëve mbështetur në aktet e nxjerra nga MASR si dhe kriteret e veçanta të hartuara dhe të propozuar nga njësia bazë (DGJA) dhe të miratuara nga Dekanati dhe Senati Akademik. Kriteret e përcaktuara, publikohen në Website zyrtar. [Ref 1.1 Statuti i UNIEL; Ref. 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të UNIEL; Ref. 1.2 Rregullore e Studimeve të UNIEL; Ref. 1.7 Rregullore e FSHH; Ref. 5.9 Urdhri për Komisionet e përhershme institucionale në UNIEL; Ref. 5. 17 Rregullore për funksionimin e komisionit të përhershëm për studentët dhe këshillimin e karrieres; Ref 1.22 Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit; Ref 1.23 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit]
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Dokumentacioni i paraqitur nga GVB përcakton qartë se kriteret e miratuara për transferime dhe njohje të studimeve bazohen te Rregullorja e IAL-së dhe rregullorja e programit të studimit. Kriteret e përcaktuara bëhen publike përmes shpalljes në faqen zyrtare të UE-së, Ditëve të Hapura, broshurave informuese dhe fushatave të marketingut në mediat lokale. [Ref 1.1 Statuti i UNIEL; Ref. 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të UNIEL; Ref. 1.2 Rregullore e Studimeve të UNIEL; Ref. 1.7 Rregullore e FSHH;
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Bazuar tek informacioni i paraqitur në DVV dhe i konfirmuar nga vizita në institucion, në fillim të çdo viti akademik, UE informon të interesuarit në lidhje me kriteret e përcaktuara për aplikimet në të gjitha programet e studimit që ky institucion ofron. Informimi bëhet përmes faqes zyrtare të UE-së. UNIEL, organizon fushata informimi dhe veprimtari promovuese, si takime dhe këshillime me nxënësit e shkollave të mesme, promovime në mediat lokale, broshura informuese etj. Në takimin e zhvilluar me GVJ, studentët pohuan se kishin marrë informacion të plotë dhe të detajuar pikërisht përmes mjeteve të informimit të sipërpërmendura. [Ref. 1.23 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit; Ref. 5.2 Kalendari i ditëve të hapura 2022; Ref 5.3 Publikimi i Spotit promovues; Ref. 5.4 Fletëpalosje promovuese institucionale të Departamentit të Gjuhëve të Huaja; Ref. 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023]
Kriteri 6. Institucioni harton	Dokumentacioni i përcjellë përmes DVV, përcakton qartë se

<p>dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara.</p>	<p>përzgjedhja e kritereve të pranimit për persona me status të veçantë, mbështetet në bazën ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi dhe në rregulloren e institucionit arsimor. Kuotat për personat përfitues për shkak të statusit të veçantë bëhen të ditura në Vendimin për miratimin e kuotave të pranimit. [Ref. 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023; Ref. 1.23 Vendim për miratimin e kritereve të pranimit për programin e studimit; Ref. 1.22 Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit]</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Të njëjtat procedura, të bazuara në të njëjtën bazë ligjore ndiqen edhe për hartimin dhe miratimin e kritereve për kandidatë nga vende të tjera, me konkretisht kandidatët nga Trojet Shqiptare me 4 kuota të përcaktuara. [Ref. 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023; Ref. 1.23 Vendim për miratimin e kritereve të pranimit për programin e studimit; Ref. 1.22 Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit]</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>GVJ konstaton se politikat e ndihmës financiare të ofruar nga institucioni, në mbështetje të kategorive në nevojë, përditësohen në çdo fillim viti akademik, përcaktohen në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe shprehen qartë në vendimet e marra në nivel institucional. [Ref. 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023; Ref. 1.23 Vendim për miratimin e kritereve të pranimit për programin e studimit; Ref. 1.22 Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit; Ref 2.1 Vendim i Bordit të Administrimit për bursat dhe përjashtimet]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ gjykon se hartimi i programit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, pranimi i studentëve në këtë program studimi dhe përzgjedhja e kritereve të pranimit për persona me status të veçantë, janë kryer në përputhje dhe procedurat e parashikuara në ligjin nr.80/2015 si dhe me aktet rregullatore në fuqi. UNIEL informon të interesuarit në lidhje me kriteret e përcaktuara për aplikimet në të gjitha programet e studimit që ky institucion ofron. Informimi bëhet përmes faqes zyrtare të UE-së. Kriteret e miratuara për transferime dhe njohje të studimeve bazohen te Rregullorja e IAL-së dhe rregullorja e programit të studimit. IAL-ja ka hartuar politika të ndihmës financiare për të mbështetur kategoritë në nevojë të cilat shprehen qartë në vendimet e marra në nivel institucional. Institucioni organizon fushata informimi dhe veprimtari promovuese në fillim të çdo viti akademik. Fushatat e informimit për programet e ofruara kryhen periodikisht dhe përfshijnë takime dhe këshillime me nxënësit e shkollave të mesme, promovime në mediat lokale, broshura informuese etj.</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Bazuar tek dokumentacioni i paraqitur nga GVB dhe takimet e zhvilluara në institucion me anëtarë të stafit akademik dhe studentë u konstatua se DGJH-ja, ve në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve. Po kështu, gjatë takimeve në institucion u konfirmua se të drejtën për dhënie informacioni e ka sekretaria mësimore sikundër dhe Zyra e Karrierës. Për këtë qëllim është vënë në dispozicion edhe faqja WEB e institucionit. [Ref. 1.2 Rregullore e Studimeve të UNIEL; Ref. 1.7 Rregullore e FSHH; Ref 1.8 Rregullore e programit të studimit; Ref 3.17 Programet mësimore të lëndëve]
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.	Pasi shqyrtoi dokumentacionin përkatës, GVJ konstatoi se të gjitha procedurat e kryera në kuadër të informimit të studentëve mbi kualifikimet e mëparshme apo studimet e pjesëshme, kryhen në përputhje me rregulloren e institucionit mbi të cilën bazohen edhe rregulloret e njësisë kryesore dhe asaj bazë. [Ref. 1.2 Rregullore e Studimeve të UNIEL; Ref. 1.7 Rregullore e FSHH; Ref. 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të UNIEL]
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në dokumentacionin e paraqitur nga GVB dhe takimet e zhvilluara në institucion me anëtarë të stafit akademik dhe studentë, u pohua se titullarët e lëndës informonin studentët mbi planin mësimor përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve që zhvillohen, vlerësimet e marra nga provimet e ndërmjetme, seminareve, detyrave të kursit, projekteve, prezantimeve dhe provimit përfundimtar. Microsoft Teams përdoret gjithashtu si platformë për informimin e studentëve dhe shkëmbimin e informacionit. Programet lëndore dhe plani mësimor janë të depozituar pranë Zyrës së Kurrikulës. [Ref. 1.2 Rregullore e Studimeve të UNIEL; Ref. 1.7 Rregullore e FSHH; Ref 4.11 Rregullorja EMS; Ref. 3 .16 Plani mësimor i programit të studimit; Ref. 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit]
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në	Bazuar tek informacioni i paraqitur në DVV, përmbyllja e detyrimeve të programit të studimit të ciklit të parë kryhet me provim të

<p>lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>përgjithshëm përfundimtar ose me punim diplome. Forma e shlyerjes së detyrimeve përfundimare, përcaktohet mbi bazën e notës mesatare të studentit. Pyetjet e formimit të përgjithshëm përllogariten me 60% të vlerësimit ndërsa 40 % bazohen mbi tri fusha të veçanta studimi (studime gjuhësore; histori e qytetërim dhe studime letrare) të cilat zgjidhen paraprakisht nga studentët gjatë semestrit të dytë të vitit të tretë. Manuali i punimit të diplomës është hartuar dhe u është vënë në dispozicion studentëve me qëllim që ti udhëzojë ata mbi format dhe procedurat e hartimit të temës së diplomës. [Ref. 1.7 Rregullore e FSHH; Ref. 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të UNIEL; 3.11 Rregullore e mikrotezës dhe provimit të formimit] Studentët pohuan se kishin marrë informacion të plotë dhe ishin orientuar nga përgjegjësi i njësisë dhe pedagogët e DGJH-së në lidhje me fondin e pyetjeve të provimit të formimit dhe organizimin e provimit të diplomës që në fillim të vitit të tretë.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Njësia bazë (DGJH) promovon programet e ciklit të parë të ofruara nga ky department. Fushatat informuese realizohen kryesisht përmes njoftimeve në mediat lokale, shpërndarjes së fletëpalosjeve, takimeve informuese me maturan të të qarkut dhe faqes WEB. [Ref. 1.7 Rregullore e FSHH; Ref. 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të UNIEL; Ref. 1.2 Rregullore e Studimeve të UNIEL; Ref 1.8 Rregullore e programit të studimit]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se njësia bazë, sekretaria mësimore, Zyra e Karrierës dhe faqja WEB e institucionit ka vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë dhe të hollësishëm. Procedurat për informimit të studentëve mbi kualifikimet e mëparshme apo studimet e pjesëshëm janë ndjekur në përputhje me rregulloren e institucionit dhe njësive të tjera. Studentët kanë marrë informacion mbi planin mësimor, përmbajtjen e syllabuseve, mënyrën dhe format e vlerësimit. Përmbyllja e detyrimeve të programit të studimit të ciklit të parë kryhet me provim të përgjithshëm përfundimtar ose me punim diplome. Forma e shlyerjes së detyrimeve përfundimare, përcaktohet mbi bazën e notës mesatare të studentit. Pyetjet e formimit të përgjithshëm përllogariten me 60% të vlerësimit ndërsa 40 % bazohen mbi tri fusha të veçanta studimi (studime gjuhësore; histori e qytetërim dhe studime letrare). Studentët pohuan se kishin marrë informacion të plotë dhe ishin orientuar nga përgjegjësi i njësisë dhe pedagogët e DGJH-së në lidhje me fondin e pyetjeve të provimit të formimit dhe organizimin e provimit të diplomës që në fillim të vitit të tretë. Përmes manualit të punimit të diplomës studentët orientohen mbi format dhe procedurat e hartimit të temës së diplomës.</i></p>


Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Pas shqyrtimit të materialit mbështetës të vënë në dispozicion dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se DGJH-ja informon studentët në fillim të çdo viti akademik mbi kurrikulat, rregulloren e programit të studimit, formën e studimit, kreditet, ngarkesën në auditor, frekuentimin dhe format e vlerësimit. Përveç dhënies së informacionit në mjediset e fakultetit, DGHH-ja përdor edhe kanale të tjera për informim si Platformën Teams, Faqen WEB, mediat lokale, sekretarinë mësimore. [Ref. 1.29 Politika e marketingut për programin e studimit; Ref 1.8 Rregullore e programit të studimit; Ref. 3 .16 Plani mësimor i programit të studimit; Ref. 3.15 Korrniza konceptuale e programit të studimit]
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Gjatë takimeve të GVJ të zhvilluara në institucion, studentët pohuan se merrnin informacion dhe udhëzoheshin në mënyrë të detajuar dhe të vazhdueshme mbi lëndët, përmbajtjen e tyre dhe veprimtaritë formuese. Studentët ishin njohur me rregulloren e programit, syllabuset dhe shpërndarja e informacionit përveçse bëhej nga pedagogët në auditor, realizohet edhe përmes faqes WEB. [Ref. 3 .16 Plani mësimor i programit të studimit; Ref. 3.15 Korrniza konceptuale e programit të studimit; Ref. 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të UNIEL; Ref. 1.2 Rregullore e Studimeve të UNIEL]
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Bazuar në dokumentacionin bazë të paraqitur, takimet me studentët dhe përfaqësues të strukturave përgjegjëse në fakultet, GVJ konstaton se zyra për Këshillim Karriere dhe Alumni i orienton studentët drejt tregut të punës dhe mundësive për zhvillimin e karrierës. Institucioni ka mbledhur të dhëna mbi nivelin e punësimit të të diplomuarve në këtë IAL për vitet akademikë; 2020-2021; 2021-2022. [Ref. 5.5 Të dhëna mbi studentët përfitues të programit të nxitjes së punësimit;; Ref. 5.6 Të dhëna mbi punësimin e të diplomuarve 2020- 2021; 2021 -2022; Ref 5.17 Rregullore për funksionimin e komisionit të përhershëm për studentët dhe këshillimin e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	karrierës]			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme mbi veprimtarinë mësimore, logjistikën dhe infrastrukturën e ngritur në mbështetje të saj. Nga takimet e zhvilluara me studentët u konfirmua se përgjegjësi i njësisë bazë, sekretaria mësimore dhe personeli akademik u japin atyre informacion në mënyrë të vazhdueshme. Si mjete për shkëmbimin e informacionit shërbejnë edhe faqja WEB dhe platforma Microsoft Teams. [Ref. 3.16 Plani mësimor i programit të studimit; Ref. 3.15 Korrniza konceptuale e programit të studimit; Ref. 1.7 Rregullore e FSHH]			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Nga takimet e zhvilluara me studentët dhe personelin e sekretarisë mësimore, u konfirmua se institucioni ka vënë në përdorim një sistem elektronik. Në fillim të vitit akademik studentët pajisen me një llogari të tyre. Platforma Teams është ende funksionale, ndërkohë që personeli akademik dhe studentët kanë mundësi komunikimi edhe përmes adresave të emailit Outlook.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se studentët janë informuar mbi kurrikulat, rregulloren e programit të studimit, formën e studimit, kreditet, ngarkesën në auditor, frekuentimin dhe format e vlerësimit, infrastrukturën dhe logjistikën. Studentët pohuan se merrnin informacion dhe udhëzoheshin në mënyrë të detajuar dhe të vazhdueshme nga personeli akademik mbi lëndët, përmbajtjen e tyre dhe veprimtaritë formuese. Studentët ishin njohur me rregulloren e programit, syllabuset dhe shpërndarja e informacionit përveçse bëhet nga pedagogët në auditor, realizohet edhe përmes faqes WEB. Institucioni ka vënë në përdorim një sistem elektronik. Në fillim të vitit akademik studentët pajisen me një llogari të tyre. Platforma Teams është ende funksionale, ndërkohë që personeli akademik dhe studentët kanë mundësi komunikimi edhe përmes adresave të emailit Outlook. Platforma Teams, Faqja WEB, dhe sekretaritë mësimore janë gjithashtu përgjegjëse për informimin e studentëve. Zyra për Këshillim Karriere dhe Alumni i orienton studentët drejt tregut të punës dhe mundësive për zhvillimin e karrierës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4



Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se FSHH-ja mban dhe ruan dokumentacionet e procesit mësimor si regjistrat bazë, regjistrat e lëndëve, planët mësimore, strukturën e vitit akademik, procesverbalet e vlerësimit të studentëve etj.</p> <p>Sekretaria mësimore ruan statistikën vjetore për numrin e studentëve të diplomuar për çdo program studimi. GVJ shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion nga sekretaria mësimore ku verifikoi se këto të dhëna janë të dokumentuara në regjistrin themeltar të studentëve dhe regjistrin e lëshimit të diplomave. Të dhënat ruhen si dokumentacion nga përgjegjësi i departamentit, Dekanati dhe Zyra e Standardeve dhe Kurrikulës. [Ref. 1.16 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHH-së; Ref 1.17 Strategjia e Zhvillimit të FSHH-së Ref. 5.6 Të dhëna mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021; 2021-2022]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se FSHH-ja dhe DGJ-ja ruan dhe dokumenton statistika vjetore për numrin e studentëve të rregjistruar në programet e ciklit të parë, si dhe tërheqjet dhe largimet nga këto programe studimi.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” për vitin akademik 2019-2020 janë rregjistruar 23 studentë me notë mesatare në hyrje 7.5; për vitin akademik 2020-2022 19 studentë me notë mesatare 7 dhe për vitin 2021-2022 18 studentë me notë mesatare 7. Ndërkohë që përgjatë këtyre viteve vetëm 2 studentë kanë kryer procedurat e transferimit të studimeve. [Ref. 1.16 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHH-së; Ref. 1.8 Rregullore e programit të studimit; Aneks Tabela 21]</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ konstatoi se sekretaria mësimore ruan në formë elektronike dhe të shkruar procesverbalet e provimeve të zhvilluara. Gjithashtu institucioni ruan të dhënat personale të studentëve në formë elektronike dhe të shkruar.</p> <p>Të gjitha të dhënat janë konfidenciale dhe mbrohen sipas legjislacionit të fuqi. [Ref. 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Ref. 1.16 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHH-së]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin</p>	<p>Sekretariatë mësimore dhe strukturat e menaxhimit të brendshëm të informacionit, monitorohen dhe vlerësohen vazhdimisht nga institucioni me qëllim përmirësimin e punës dhe funksionimit të tyre [Ref. 1.16 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të</p>

(sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	sekretarisë mësimore te FSHH-së; Ref. 1.8 Rregullore e programit te studimit; Ref. 1.7 Rregullore e FSHH]			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Sekretaria mësimore ruan informacionin që lidhet me cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje dhe e ve në dispozicion të strukturave përgjegjese të interesuara. Si pjesë e veprimtarisë promovuese dhe informuese të departamentit, vlerësohet edhe puna e bërë nga njësia bazë për informimin e studentëve mbi mundësitë e ofruara nga ky departament për punësimin e tyre pas diplomimit.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se sekretaritë mësimore dhe strukturat e menaxhimit të brendshëm të informacionit, monitorohen dhe vlerësohen vazhdimisht nga institucioni me qëllim përmirësimin e punës dhe funksionimit të tyre. FSHH-ja dhe DGJH-ja ruan dhe dokumenton statistika vjetore për numrin e studentëve të rregjistruar në programet e ciklit të parë, si dhe tërheqjet dhe largimet nga këto programe studimi. Sekretaria mësimore ruan statistikat vjetore për numrin e studentëve të diplomuar për çdo program studimi. GVJ shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion nga sekretaria mësimore ku verifikoi se këto të dhëna janë të dokumentuara në regjistrin themeltar të studentëve dhe regjistrin e lëshimit të diplomave. Të dhënat ruhen si dokumentacion nga përgjegjësi i departamentit, Dekanati dhe Zyra e Standardeve dhe Kurrikulës Sekretaria mësimore ka ruajtur në formë elektronike dhe të shkruar procesverbalet e provimeve të zhvilluara dhe të dhënat personale të studentëve në formë elektronike dhe të shkruar si dhe informacion për cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se FSHH-ja dhe DGJH-ja sigurojnë përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimarrëse dhe këshilluese. Studentët gëzojnë të drejtën e vendimarrjes bazuar në LAL, nr.80/2015, neni 99 dhe në Statutin e UE-së. Studentët kishin informacion të plotë mbi të drejtën e përfaqësimit në organet vendimarrëse dhe këshilluese të institucionit sikurse dhe në këshillat e tyre studentorë në nivel njësie bazë dhe njësie kryesore. Ref. 1.8 Rregullore e programit te studimit; Ref. 1.7 Rregullore e FSHH; Ref. 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Ref. 1.2 Rregullore e Studimeve të UNIEL]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Gjatë takimeve që studentët zhvilluan me GVJ, ata konfirmuan faktin se përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e Senatit Akademik, kanë të drejtë diskutimi dhe të drejtë vote të barabartë me anëtarët e tjerë. Studentët u shprehën se ata marrin pjesë aktive në komisionet e ngritura pranë institucionit, stafi akademik dhe ai mbështetës inkurajojnë angazhimin e tyre në të gjitha veprimtaritë e organizuara. [Ref. 5.7 Vendimi për Komisionin Institucional Zgjedhor; Ref. 5.8 Urdhri për ngritjen e Komisionit të Vetëvlerësimit për Akreditimin Institucional; Ref. 5.11 Urdhri për grupin e punës për raportin e vetëvlerësimit për programin; Ref. 5.14 Vendimi i Dekanit të FSHH-së për ngritjen e GVB 2022]</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit të programit të studimit realizohet kryesisht nëpërmjet pyetësorëve që u drejtohen atyre. Gjatë takimit që GVJ kreu me studentët, ata u shprehën se ndiheshin të përfshirë dhe të angazhuar në proceset vendimarrëse të departamentit dhe se vlerësimi i mendimeve të tyre bëhej objektivisht, duke ju siguruar atyre barazi dhe paanshmëri. [Ref. 1.7 Rregullore e FSHH]</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Kuadri rregullator i DGJH-së u siguron studentëve mundësinë për të ankimuar rezultatin e vlerësimit të kontrollit të dijeve, si dhe të drejtën për të kërkuar rishikim apo rivlerësim.</p> <p>Gjatë takimit që GVJ realizoi me grupin e studentëve, ata u shprehën se ishin të informuar me mundësinë e ankimimit, madje ndanë dhe përvojat e tyre për rastet në të cilat ata e kishin ushtruar këtë të drejtë. [Ref. 1.8 Rregullore e programit te studimit; Ref. 1.7 Rregullore e FSHH]</p>

Konkluzione	GVJ gjykon se studentët gëzojnë të drejtën e përfaqësimit në organet vendimarrëse dhe këshilluese të institucionit sikurse dhe në këshillat e tyre studentorë në të gjitha nivelet. Studentët u shprehën se ndiheshin të përfshirë në proceset vendimarrëse të departamentit dhe se vlerësimi i mendimeve të tyre bëhej objektivisht. Studentëve u sigurohej mundësia për të ankimuar rezultatin e vlerësimit të kontrollit të dijeve, dhe gëzonin të drejtën për të kërkuar rishikim apo rivlerësim.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Referuar dokumentacionit të paraqitur nga GVB, studentëve u sigurohet e drejta për informim dhe për këtë qëllim institucioni ka ngritur Drejtorinë e Karrierës dhe ALUMNI dhe NJSBC. NJSBC është strukturë institucionale e ngritur pranë Drejtorisë së Standardeve dhe Kurrikulave. Gjatë takimit të zhvilluar me përfaqësues të kësaj strukture, GVJ konstatoi se kjo njësi siguron ekspertizën dhe synon të përmirësojë ecurinë e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Gjuhë Angleze. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të përfshirë në DVV, GVJ konstaton se informimi dhe këshillimi i studentëve kryhet edhe përmes Komisionit të Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët dhe Këshillimit të Karrierës. Gjatë vizitës, studentët rikonfirmuan faktin se këto struktura angazhohen dhe ofrojnë mbështetjen e duhur për çështje që lidhen me programin e studimit, procesin mësimor dhe u vjen në ndihmë studentëve përmes seancave të konsultimit. [Ref. 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Ref. 5.12 Miratimi dhe funksionimi i Programit të Transparencës UNIEL; Ref 5.17 Rregullore për funksionimin e komisionit të përhershëm për studentët dhe këshillimin e karrierës]
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre	Referuar dokumentacionit të paraqitur nga GVB, studentëve u sigurohet e drejta për informim dhe për këtë qëllim institucioni ka ngritur strukturat e Drejtorisë së Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, njësinë e NJSBC, Komisionin e Garantimit të Standardeve të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>me Studentët dhe Këshillimin e Karrierës pranë FSHH. Studentët informohen që në fillim të vitit të parë akademik mbi programet e studimit, organizimin dhe përmbajtjen e tij, kohëzgjatjen, akreditimin, mundësitë për diplomim, kalendarin akademik, sezonin e provimeve dhe informacione të tjera të nevojshme. [Ref 5.17 Rregullore për funksionimin e komisionit të përhershëm për studentët dhe këshillimin e karriereë; Ref 5.13 Vendim i FSHH-së për ngritjen e NJSBC-se; Ref. 5.16 Rregullore e NJSBC-së]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Drejtoria për Këshillimin dhe Karrierën është një strukturë institucionale e cila mbështet, mban kontakte me studentët e diplomuar dhe informon organet dhe autoritetet drejtuese mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve.</p> <p>Veç të tjerave, studentët theksuan faktin se kjo strukturë i informon ata në lidhje me organizime të ndryshme si konferenca, trajnime, projekte dhe veprimtari të tjera social-kulturore dhe artistike. Bazuar tek informacioni i shqyrtuar, GVJ konstatoi se studentët e programit Bachelor në “Gjuhë Angleze” kanë marrë pjesë në veprimtari të organizuara nga njësia bazë si dhe në projekte shkencore në rang departamenti si Programi Debating Economics, 3E, Panairi EU 4 Education, Tryezë e Rrumbullakët për çështjet e barazisë gjinore etj. Gjithshtu studentët janë angazhuar edhe në punimet shkencore të pedagogëve në botimet tek buletini UNIEL. [Ref 1.1 Statuti i UNIEL, Ref 1.10 Struktura organizative e UNIEL dhe FSHH-së ; Ref. 1.30 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; Ref 5.6 Të dhëna mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021; 2021-2022]</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra për Këshillimin dhe Karrierën mban kontakte me studentët e diplomuar dhe informon organet dhe autoritetet drejtuese mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve. Edhe nga ana e DGJH-ja janë bërë përpjekje për të krijuar pika kontakti midis kësaj njësie dhe studentëve të punësuar. Përmes pyetësorëve të realizuar me studentët është krijuar mundësia për gjurmimin e studentëve të punësuar. GVJ gjykon se pyetësorët nuk përmbajnë të dhëna të plota dhe informacioni nuk është i përpunuar në mënyrë të saktë për të dhënë një pasqyrë të qartë për nivelin e punësimit të studentëve të diplomuar nga ky program studimi.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se informimi dhe këshillimi i studentëve kryhet edhe përmes Komisionit të Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët dhe Këshillimit të Karrierës, Drejtorisë së Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, njësinë e NJSBC, Komisionin e Garantimit të</i></p> <p><i>Standardeve të Cilësisë. Drejtoria për Këshillimin dhe Karrierën mban kontakte me studentët e diplomuar dhe informon organet dhe</i></p>

	<i>autoritetet drejtuese mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve. GVJ gjykon se pyetësorët e realizuar nga njësia DGJH nuk përmbajnë të dhëna të plota dhe informacioni nuk është i përpunuar në mënyrë të saktë për të dhënë një pasqyrë të qartë për nivelin e punësimit të studentëve të diplomuar nga ky program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet mesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR



Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Referuar informacionit në RVB dhe dokumentacionit shoqërues të tij, GVJ konstaton se kuadri rregullator i UE-së, rregullorja e brendshme e FSHH-së dhe Departamentit (Neni 6-Funksioni dhe detyrat e personelit akademik) parashikojnë zhvillimin e metodave të ndryshme inovative nga personeli akademik, (Ref. 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Ref. 1.14 Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja) . GVJ konstaton se UE ka hartuar një (1) udhëzues në nivel institucional për përdorimin e paketës Microsoft Teams, “Guida e pedagogut, mësimi on line Microsoft Teams”, përgjatë kohës së pandemisë, platformë, e cila është ende aktive, si edhe në kuadër të përdorimit të sistemit elektronik të brendshëm nga personeli akademik ka hartuar rregullore të posaçme (Ref. 6.1 Guida e pedagogut: Mesimi online nepermjet Microsoft teams; Ref.4.11 Rregullorja EMS) .
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Duke iu referuar RVB-së dhe dokumentacionit shoqërues të tij, GVJ konstaton se me Vendim të Senatit Akademik, UE ka ngritur Komisionin e përhershëm në nivel institucioni për Garantimin e Standarteve të Cilësisë së institucionit dhe Programeve të Studimit në UNIEL, si edhe ka hartuar Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e këtij komisioni (Ref. 5.16 Rregullore e NJSC të UE “A.Xhuvani”; Ref. 5.9 Urdhëri për Komisionet e përhershme Institucionale në UNIEL) . GVJ konstaton se struktura, e cila ofron

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>ekspertizë në zbatimin e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit të mësimdhënies, përfshirjes së studentëve në procesin e vlerësimit është Komisioni i përhershëm në nivel institucioni për Garantimin e Standarteve të Cilësisë së institucionit dhe Programeve të Studimit në UNIEL, Neni 5, pika b. (Ref. 5.16 Rregullore e NJSC të UE “A.Xhuvani”).</p> <p>GVJ konstaton se FSHH, si njësi kryesore, me vendim Dekanati ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë dhe Programeve të Studimit të Fakultetit të Shkencave Humane, (Ref. 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme në fakultet). Referuar RVB-së dhe takimit në institucion, Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë” (SBC) është pjesë e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (SBC). GVJ konstaton se integrimi i strukturës së SBC nuk është parashikuar në Rregulloren e organizimit dhe funksionimit UNIEL, Neni 14 (Ref. 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL).</p> <p>GVJ konstaton nga dokumentacioni i paraqitur në DVV se përbërja e NJSBC-së është e njëjtë me Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë dhe Programeve të Studimit të Fakultetit të Shkencave Humane. GVJ nuk disponon sqarime të dokumentuara mbi funksionimin e këtyre strukturave, që rezultojnë me të njëjtën përbërje, por me emërtime të ndryshme. (Ref. Aneks RVB, Tabela nr. 24, Te dhena per anetaret e NJSBC-se ne nivel fakulteti (FSHH)).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>GVJ konstaton nga dokumentacioni i paraqitur në DVV, se UE garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave dhe metodave inovative të mësimdhënies duke i anëtarësuar ata në struktura që sigurojnë cilësinë dhe standartet në procesin mësimor në nivel isitucional dhe në nivel fakulteti, të tilla si: 1.Komisioni i përhershëm në nivel institucioni për Garantimin e Standarteve të Cilësisë së institucionit dhe Programeve të Studimit në UNIEL; 2. Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë dhe Programeve të Studimit të Fakultetit të Shkencave Humane; 3. Komisioni i Përhershëm për Marrdhëniet me Studentët dhe Këshillimin e Karrierës (Ref. 5.9 Urdhri për komisionet e përhershme institucionale në UNIEL; Ref. 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme në fakultet).</p> <p>GVJ konstaton se përfshirja e studentëve reflektohet në këto forma:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Studentët kanë mundësi që të zgjedhin në mënyrë të pavarur përfaqësuesin e tyre në Senatin Akademik të UE-së si dhe në Komisionin e Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët dhe Këshillimin e Karrierës. (5.9 Urdheri per Komisionet e perhershme Institucionale ne UNIEL). 2. Studentët marrin pjesë në anketime që realizohen në semestrin e parë para provimeve apo në fund të vitit akademik (Ref. 6.2 Publikimi i

	<p>Raportit 2021-2022).</p> <p>3. Studentët janë përfshirë si pjesë integrale e procesit të monitorimit të cilësisë, ku evidentohet se një (1) student nga FSHH është anëtar në Komisionin e përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë dhe Programeve të Studimit të Fakultetit të Shkencave Humane. (5.10 Urdhri për komisionet e përhershme në fakultet).</p> <p>GVJ konstaton nga dokumentacioni i paraqitur dhe vizita në institucion se DGJH nëpërmjet drejtuesit kryesor të saj organizon takime formale dhe informale të vazhdueshme me studentët për mënyrën e zhvillimit të programit mësimor, dhe më specifiku për rastet e ankimimit, të cilat trajtohen sipas rregulloreve në fuqi (Ref. 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL; Ref. 1.7 Rregullore e FSHH-se; Ref. 1.8 Rregullore e Programit të Studimit).</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të paraqitur në RVB, materialeve mbështetëse në DVV dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se Drejtoria e Kurikulave dhe Sigurimit të brendshëm të Cilësisë është struktura përgjegjëse në nivel institucioni për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, duke bërë publike nëpërmjet raporteve përkatëse rezultatet e vlerësimit pas anketimeve të studentëve. Nga vizita në institucion u konstatua se DSKSBC aplikon instrumentin matës (pyetësorin e studentëve), i cili përdoret për opinionin e tyre sipas përkatësisë së tyre në fakultetet e UE-së. Kjo drejtori analizon të dhënat dhe harton raportin e vlerësimit të studentëve (Ref.6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; Ref.6.3 Urdhërat për zhvillimin e pyetësorëve instiucionalë 2021-2022).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstaton se DGJH është përfshirë në gjurmimin e studentëve të diplomuar në Programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” nëpërmjet aplikimit të një pyetësori dhe ka publikuar një raport duke evidentuar përparësitë dhe dobësitë e këtij program studimi (Ref. 5.15 Pyetësori i Alumnit zhvilluar nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja.pdf; Ref. 5.18 Raport mbi rezultatet e pyetësorit zhvilluar nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja). GVJ konstaton se UE promovon format e suksesshme të mësimdhënies, duke zgjeruar vazhdimisht infrastrukturën mbështetëse, nëpërmjet pajisjes së auditoreve me mjete të teknologjisë së informacionit, pasurimit të fondit të librave, garantimit të shërbimit të internetit në të gjithë mjedisin universitar. GVJ konstaton se UE i ka mundësuar personelit akademik trajnime dhe kualifikime të ndryshme në përputhje me fushat e studimit si brenda e jashte vendit. (Ref. 3.1 Lista e marreveshjeve të bashkepunimit Erasmus+; Ref. 3.2 Te dhena për mobilitetin e personeleve; Ref. I. I 2 Lista e marreveshjeve të bashkepunimit)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se UE ka ngritur struktura dhe drejtori më qëllim ndjekjen e një politike të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies, të tilla si: 1. Komisioni i përhershëm në nivel</i></p>

institucioni për Garantimin e Standarteve të Cilësisë së institucionit dhe Programeve të Studimit në UNIEL 2. Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë dhe Programeve të Studimit të Fakultetit të Shkencave Humane 3. Drejtoria e Kurikulave dhe Sigurimit të brendshëm të Cilësisë.

GVJ konstaton se në infomacionin e paraqitur në RVB, Statutin e UE-së, Rregulloren e Komisionit të përhershëm në nivel institucioni për Garantimin e Standarteve të Cilësisë së institucionit dhe Programeve të Studimit në UNIEL, citohet edhe struktura "Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë", por GVJ vëren se në dokumentacionin shoqërues në DVV, kjo strukturë nuk është formalisht e ngritur nga institucioni. Referuar vizitës në institucion dhe organigramës së UE-së, GVJ konstaton se kjo strukturë është intergruar në Drejtorinë e Kurikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

GVJ konstaton se përfshirja e studentëve të Programit Bachelor në "Gjuhë Angleze" lidhur me vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve reflektohet në këto forma: 1. zgjedhja në mënyrë të pavaruar të përfaqësuesit të tyre në Senatin Akademik të UE-së, 2. zgjedhja në Komisionin të Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët dhe Këshillimin e Karrierës, 3. anëtarësimi në Komisionin e përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë dhe Programeve të Studimit të Fakultetit të Shkencave Humane. 4. Takimet me drejtuesin e DGJH.

GVJ konstaton se UE është i kufizuar në hartimin e udhëzuesve të posaçëm në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. Ky kufizim kompensohet me kuadrin rregullator të UE-së, që përmban në mënyrë të tërthortë udhëzime të kësaj natyre.

Shkalla e përmbushjes së standardit				
	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
		X		

Standardi VL2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit	GVJ konstaton se UE në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.

Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.

Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, Neni 103, “Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë” dhe Satutin e UE-së, Neni 71, UE ka hartuar urdhra për ngritjen e komisioneve të përhershme në nivel institucional të garantimit të cilësisë, si dhe urdhëra për zhvillimin e pyetësorëve institucionale për mësimin në distancë (2020-2021) dhe zhvillimin e pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe programin e studimit (2021-2022); (Ref. 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme në fakultet); Ref. 6.3 Urdhërat për zhvillimin e pyetësorëve instiucionalë 2021-2022.pdf). UE ka hartuar një (1) rregullore të posaçme të miratuar nga Senati akademik për funksionimin Komisionit të përhershëm në nivel institucioni për Garantimin e Standarteve të Cilësisë së institucionit dhe Programeve të Studimit në UNIEL (KPIGSCPS) (Ref 5.16 Rregullore e NJSC të UE “A.Xhuvani).

GVJ konstaton se studentët janë pjesë integrale e procesit të monitorimit të cilësisë, nëpërmjet përfaqësimit të tyre në komisionet për garantimin e standarteve të cilësisë në nivel institucioni (UE) dhe në nivel fakulteti (FSHH) (Ref. 5.9 Urdhri per Komisionet e perhershme Institucionale ne UNIEL; Ref. 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme në fakultet.pdf).

GVJ, referuar RVB-së dhe dokumentacionit në DVV, konstaton se strukturat për monitorimin e cilësisë kanë mbajtur relativisht funksional sistemin e vlerësimit të brendshëm duke publikuar një (1) raport vjetor (2021-2022) për sigurimin e cilësisë në nivel institucioni, ku përfshihet dhe vlerësimi për FSHH-në në tërësi, dhe jo në veçanti për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” (Ref. 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022). Gjithashtu GVJ vëren se nuk është kryer procesi i vlerësimit periodik të performancës akademike siç edhe parashikohet në Strategjinë e Zhvillimit të FSHH-së, (Pika 5.5/4) dhe në strategjinë e zhvillimit të DGJH (Ref. 1.17 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Humane; Dok. Shtesë: Strategjia e zhvillimit të DGJH). Ky konstatim reflektohet edhe në Relacionin për analizën vjetore të punës mësimore të FSHH, 2021-2022, në rubrikën “Disiplina në punë dhe performanca e pedagogut” (Ref. 1.18 Analiza vjetore e Fakultetit të Shkencave Humane 2020-2021, 2021-2022)

GVJ kontaton se Drejtoria e Kurikulave dhe Sigurimit të brendshëm të Cilësisë zbaton procedurat dhe urdhërat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), por nuk harton politika dhe nuk ka kompetenca për miratimin e instrumentave matës të procesit të mësimdhënies ose vlerësimit të personelit akademik. GVJ referuar vizitës në institucion dhe materialit mbështetës në DVV, nuk konstaton vendime për miratimin e pyetësorëve të aplikuar (kompetencë e KPIGSCPS), si edhe evidenton mungesën e një strategjie institucionale të Sistemit të

	<p>Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë sipas VKM 824, 24.12.2021/Miratimi i Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë. (Ref.VKM 824, 24.12.2021//Miratimi i Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë; (Ref. 1.3 Strategjia e UNIEL).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni, me të cilin UE ka bashkëvepruar për procesin e vlerësimit të jashtëm, siç është parashikuar në Ligjin për Arsimin e Lartë nr.80/2015, është Agjensia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. Universiteti i Elbasanit ka kaluar procesin e akreditimit institucional dhe me Vendim të BA, Nr. 49, dt. 27.11.2020 është i akredituar për gjashtë (6) vite (Ref. 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional). GVJ konstaton se programi i studimeve Bachelor në “Gjuhë Angleze” nuk i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm deri më tani, por në kuadër të procesit të akreditimit institucional, referuar RVB, ka kryer vlerësim të brendshëm. GVJ nuk evidenton raporte të mëparshme të vlerësimit të brendshëm, specifikisht për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” në dokumentacionin shoqëruar në DVV, që shërbejnë për vlerësime analitike krahasuese. FSHH dhe DGJH kryejnë analizën vjetore të punës mësimore. GVJ konstaton se treguesit e vetëvlerësimit nuk janë të përcaktuara formalisht në manuale apo paketa të instrumentave të cilësisë (Ref. 118 Analiza vjetore e Fakultetit të Shkencave Humane 2020-2021, 2021-2022 ; Ref. 1.19 Analiza vjetore e departamentit të gjuhëve të huaja 2021-2022)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton nga dokumentacioni shoqëruar në RVB dhe takimi në institucion se strukturat përgjegjëse: Komisioni i përhershëm në nivel institucioni për Garantimin e Standarteve të Cilësisë së institucionit dhe Programeve të Studimit në UNIEL; Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë dhe Programeve të Studimit të Fakultetit të Shkencave Humane, si dhe Drejtorja e Kurikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë nuk kanë hartuar dhe miratuar politika dhe paketa të posaçme instrumentash për garantimin e standarteve të cilësisë, në efekt të zbatimit të urdhrave për vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në UE. GVJ konstaton se për vlerësimin e cilësisë është aplikuar një (1) pyetësor studentor me 13 çështje (pyetje të mbyllura) dhe disa pyetje të hapura, GVJ nuk disponon një model të pyetësorit në DVV. GVJ konstaton se pyetësori është i kufizuar në grumbullimin e të dhënave dhe nuk nxjerr përfundime konkrete që lidhen ngushtësisht me programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” (Ref. 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022).</p> <p>GVJ konstaton se rregullorja e NJSBC-së, e cila citohet si e tillë në RVB, është rregullorja e funksionimit të Komisionit të Përhershëm të Standarteve në nivel institucional (KPGISCP), (Ref 5.16 Rregullore e NJSC të UE “A.Xhuvani”)</p>

Konkluzione

GVJ konstaton se institucioni me të cilin UE ka bashkëvepruar për procesin e vlerësimit të jashtëm, sipas parashikimit në Ligjin për Arsimin e Lartë nr.80/2015, është Agjensia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. Univeriteti i Elbasanit ka kaluar procesin e vlerësimit të jashtëm nga kjo agjensi dhe me Vendim të BA Nr. 49 dt. 27.11.2020 është i akredituar për gjashtë (6) vite. GVJ konstaton nga dokumentacioni shoqërues në RVB dhe takimi në institucion se strukturat përgjegjëse: Komisioni i përhershëm në nivel institucioni për Garantimin e Standarteve të Cilësisë së institucionit dhe Programeve të Studimit në UNIEL nuk ka hartuar dhe miratuar politika dhe paketa të posaçme instrumentash për garantimin e standarteve të cilësisë, në efekt të zbatimit të urdhrave për vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në UE.

GVJ konstaton se për vlerësimin e cilësisë është aplikuar një (1) pyetësor studentor me 13 çështje (pyetje të mbyllura) dhe disa pyetje të hapura, i cili nuk shoqërohet me vendimin e miratimit të tij nga Komisioni i përhershëm në nivel institucioni për Garantimin e Standarteve të Cilësisë së institucionit dhe Programeve të Studimit në UNIEL, si edhe përcaktohet në urdhërat institucionalë. GVJ konstaton se pyetësori është i kufizuar në grumbullimin e të dhënave dhe Raporti i paraqitur në DVV nuk nxjerr përfundime konkrete që lidhen ngushtësisht me Programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze". GVJ konstaton se objektivat dhe realizimet e vlerësimit periodik të mësimdhënies, janë parashikuar në Statutin dhe Rregulloren e UE-së, por nuk janë parashikuar në strategjinë e zhvillimit të UE-së, dhe as në strategji të posaçme për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së institucionit. GVJ rekomandon që institucioni të hartojë dhe të zbatojë strategji institucionale për cilësinë, si edhe të miratojë formalisht Paketa të unifikuara të Instrumentave Matës për garantimin e standarteve të Cilësisë në UE.

Shkalla e përbushjes së standardit


Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
		X	





Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Referuar informacionit në RVB dhe dokumentacionit shoqërues të tij, GVJ evidenton se UE zbaton një procedurë të formalizuar e të dokumentuar, përta i përket mekanizmave për shqyrtimin dhe mbikëqyrjen periodike të Programeve të studimit.</p> <p>UE me vendim të Rektoratit të UE-së ka urdhëruar zhvillimin e pyetësorëve të studentëve për vlerësimin e procesit mësimor në distancë (viti akademik 2020-2021) dhe fillimin e procesit të vlerësimit periodik të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, (viti akademik 2021-2022), duke përcaktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e tyre dhe ndjekjen e procesit, konkretisht: Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Dekanatet e fakulteteve, si dhe përfaqësi të studentëve, në rolin e anëtarëve të Komisioneve për garantimin e Cilësisë. GVJ konstaton se pas zhvillimit të pyetësorëve DKSBC ka hartuar Raportin për Vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në UE. Ky raport përfshin përparësitë, mangësitë dhe rekomandimet për vlerësimin tërësor në nivel institucioni. Ndërsa rezultatet e pyetësorit jepen në nivel fakulteti (Ref. 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022). Raporti i vlerësimit sipas urdhërave të aplikimit i përcillet Komisionit të përhershëm të Standarteve dhe Rektorit të UE-së (6.3 Urdhërat për zhvillimin e pyetësorëve institucionalë 2021-2022; Ref 5.16 Rregullore e NJSC të UE "A.Xhuvani").</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se në dokumentacionin e paraqitur në DVV, është pasqyruar vetëm Raporti i Vlerësimit për vitin akademik 2021-2022. Ky raport i është bërë i ditur Rektorit të UE-së dhe Komisionit të përhershëm në nivel institucioni për Garantimin e Standarteve të Cilësisë së Institucionit dhe Programeve të Studimit në UNIEL (Ref. 6.3 Urdhërat për zhvillimin e pyetësorëve institucionalë 2021-2022). GVJ konstaton se në DVV nuk është pasqyruar vendimi për miratimin e formatit dhe përmbajtjes së pyetësorit të aplikuar në procesin e vlerësimit. GVJ konstaton se është aplikuar vetëm një (1) pyetësor me 13 pyetje të mbyllura të ndara në dy kategori: procesi i mësimdhënies, (8 pyetje) dhe performanca e pedagogut (5 pyetje), si edhe disa pyetje të hapura (Ref. 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022 ;Ref. 6.3 Urdhërat për zhvillimin e pyetësorëve institucionalë 2021-2022).</p> <p>Raporti i vlerësimit i paraqitur në DVV paraqet të dhëna në nivel institucional dhe njësie kryesore, konkretisht për Fakultetin e Shkencave Humane. Rezultatet e zhvillimit të pyetësorit të studentëve kanë identifikuar</p>

	<p>problematika të procesit të mësimdhënies të tilla: si vlerësimi i drejtë në provime, përfshirja e literaturës së huaj plotësuese, shtimi i punëve laboratorike dhe kthimi i leksioneve në nivel më praktik. Këto rezultate shërbejnë për dhënien e rekomandimeve dhe ngritjen e 'Planit të masave' për eliminimin e problematikave. GVJ-evidenton se këto rezultate nuk lidhen ngushtësisht me programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" (Ref. 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022). GVJ konstaton se DGJH kryen analizën e veprimtarisë mësimore për programet e studimit që ofron, por nuk e mbështet atë në tregues të standartizuar të vlerësimit të cilësisë. GVJ konstaton se drejtuesi i Departamentit rekomandon kryerjen e vlerësimit të performancës së personelit akademik (PAE/PAK) në dy modalitete: nga drejtuesi i departamentit dhe nga vetë personeli akademik (procesi i vetëvlerësimit). GVJ konstaton nga dokumentacioni në DVV se ky proces nuk është kryer për personelin akademik të angazhuar në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" (Ref.1.19 Analiza vjetore e departamentit të gjuhëve të huaja 2021-2022). GVJ vëren se Raporti i paraqitur në DVV për veprimtarinë e programit të studimit "Bachelor në Gjuhë Angleze", pasqyron të dhëna vetëm për rubrikën e kërkimit shkencor të DGJH (Ref.1.28 Raport për veprimtarinë e programit të studimit "Bachelor në Gjuhë Angleze" për periudhën 2016-2022).</p> <p>GVJ rekomandon që procesi i vlerësimit të brendshëm në nivel Fakulteti dhe në nivel programi studimi, të kryhet dhe të ndiqet për mbarëvajtjen e tij nga Komisioni për Garantimin e Standarteve të Cilësisë në Fakultetin e Shkencave Humane, i cili pas gumbullimit dhe përpunimit të të dhënave, bën publik raportin e vlerësimit në Dekanat, që më pas t'u përcillet departamenteve përkatëse, në mënyrë që njësia bazë të marrë masa për plotësimin e rekomandimeve që dalin nga vlerësimi i brendshëm. Kjo procedurë është konform Udhëzimit të MASR, Nr. 27, dt.29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike, ndihmës akademike dhe administrative në IAL-të publike", i cili përcakton strukturat me karakter ndihmës akademik/ndihmës akademike me karakter administrative në nivel njësie kryesore, (konkretisht FSHH) (Pika 6/a), dhe si rrjedhojë ka varësi funksionale nga Dekani i Njesisë kryesore përkatëse, në këtë rast, Dekanin të FSHH (Pika 15), (Ref. 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme në fakultet.pdf . Ref . Udhëzimi MASR, Nr. 27, dt.29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike, ndihmës akademike dhe administrative në IAL_ të publike")</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo</p>	<p>GVJ konstaton nga vizita në institucion, se Përgjegjësi i DGJH në bashkëpunim me stafin akademik çdo fillim viti akademik mer në shqyrtim programet mësimore, për ndonjë ndryshim të nevojshëm në varësi të rekomandimeve nga studentët dhe stafi akademik, po ashtu, ai cakton grupet mësimore dhe kërkimore dhe në bashkëpunim realizon diskutime, si dhe vëzhgime në auditor me efekt përmirësimin e procesit mësimor. GVJ konstaton se mobiliteti i personelit akademik të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë angleze", si edhe angazhimi i profesorëve të ftuar, ka garantuar një përvojë më të larmishme në mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit. Referuar vizitës në institucion (takimi me personelin akademik dhe studentët), GVJ konstaton se mobiliteti i studentëve dalës</p>

<p>detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>(outgoing) në institucione ndërkombëtare, të cilët kanë programe të ngjajshëm studimi, ose studentëve hyrës (incoming) provon njohjen e krediteve të programit të studimit dhe metoda mësimdhënieje të standardizuara ndërkombëtarisht. GVJ konsaton se për vitin akademik 2021-2022, tre (3) studentë nga programi i studimit Bachelor në Gjuhë angleze janë aktivizuar në projekte ndërkombëtare me qëllim mobilitetin e tyre në universitete të huaja dy (2) studentë në universitetin e Pitestit dhe një (1) në Universitetin e Selanikut, ndërsa në vitin akademik 2019-2020 ka patur mobilitet për një (1) student në “Catholic University of Lublin”, Poloni (3.2 Të dhëna për mobilitetin e personave FSHH.pdf; Ref. 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021, f. 12- 13; Ref. 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>GVJ konstaton nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV se UE ka gjurmuar punësimin e studentëve të diplomuar në nivel institucioni (Ref. 5.6 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarëve 2020-2021). GVJ konstaton referuar RVB-së se Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, mbledh dhe përpunon periodikisht të dhëna në lidhje me gjurmimin dhe punësimin e studentëve (Ref.5.6 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarëve 2020-2021/ 2021-2022). GVJ vëren se DGJH, ka hartuar një (1) pyetësor për Alumnin të Programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze (Ref. 5.15 Pyetësori i Alumnit zhvilluar nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja.pdf . 5.18 Raport mbi rezultatet e pyetësorit zhvilluar nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja). GVJ evidenton se ky pyetësor nuk është miratuar me vendim të strukturave përgjegjëse për garantimin e cilësisë në institucion. GVJ gjithashtu konstaton se UE nuk ka hartuar dhe miratuar një paketë të standartizuar për instrumentat matës të cilësisë në institucion. GVJ rekomandon se komisioni i përhershëm i cilësisë në nivel institucioni dhe komisioni i cilësisë në fakultet duhet të miratojnë, pasurojnë, rifreskojnë dhe aplikojnë mekanizma konkretë dhe gjithëpërfshirës, të llojit sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet për as përkjet programeve të studimit.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ evidenton se UE zbaton një procedurë të formalizuar e të dokumentuar, për as i përkjet kuadrit rregullator për shqyrtimin dhe mbikqyrjen periodike të programeve të studimit , ku rezulton se UE me vendim të Senatit Akademik:</i></p> <p><i>1.- ka ngritur Komisionin e përhershëm në nivel institucioni për Garantimin e Standarteve të Cilësisë së institucionit dhe Programeve të Studimit në UNIEL; 2.- ka miratuar Rregulloren e funksionimit këtij komisioni; 3- ka urdhëruar me Vendim të Rektoratit të UE-së zhvillimin e pyetësorëve të studentëve për vlerësimin e procesit mësimor në distancë (viti akademik 2020-2021/ dhe për vlerësimin periodik të programeve</i></p>

	<p>(2021-2022). GVJ evidenton se në DVV është paraqitur një (1) Raport i vlerësimit periodik të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në UE, viti akademik (2021-2022).</p> <p>GVJ konstaton se raporti i paraqitur në DVV shpreh të dhëna në nivel institucional dhe njësie kryesore, Fakulteti i Shkencave Humane, por nuk përmban të dhëna direkte konkretisht për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”.</p> <p>GVJ konstaton se është aplikuar vetëm një (1) pyetësor për procesin e mësimdhënies me 13 pyetje të mbyllura të ndara në: procesi i mësimdhënies, (8 pyetje) dhe performanca e pedagogut (5 pyetje), si dhe disa pyetje të hapura. Nga vizita në institucion GVJ verifikoi se pyetësori i përdorur nga DKSBC ka qenë ekzistues dhe nuk është ndryshuar, përmirësuar ose rifreskuar. GVJ konstaton se ky pyetësor nuk mbulon të gjitha rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira dhe UE nuk ka dalur me një Plan masash ose rekomandimesh për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijm të cilësisë.</p> <p>GVJ konstaton se UE nuk hartuar një “Manual të Cilësisë” për institucionin në kuadër të politikë bërjes për sektorin e cilësisë, si dhe nuk ofron një “Paketë të instrumentave matës për sigurimin e Cilësisë në UE”.</p> <p>GVJ konstaton se NJSBC është strukturë e integruar në Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (Drejtori e ngritur në nivel institucional). GVJ konstaton se Komisioni për garantimin e standarteve të cilësisë në FSHH nuk ka rregullore të posaçme për të vepruar si strukturë e brendshme e Fakultetit të Shkencave humane. Rregullorja e tij miratohet nga KPGSCIPS (Neni 5/pika h).</p>		
Skalla e përmbyshjes së standardit	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
	X		

Standardi VL4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Statuti i UE-së (Neni 71) ka parashikuar dhe garanton politika dhe procedura të brendshme të cilësisë dhe ka ngritur struktura në nivel institucional si Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe në nivel fakulteti ka ngritur Komisionin e përhershëm për garantimin e standarteve të cilësisë dhe programeve të studimit në FSHH. Në kuadër të gjithëpërfshirjes së palëve të lidhura me programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, DGJH ka kryer gjurmimin e studentëve të diplomuar pranë këtij departamenti, (Ref. 5.15 Pyetësori i Alumnit zhvilluar nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja.pdf . 5.18 Raport mbi rezultatet e pyetësorit zhvilluar nga Departamenti i Gjuhëve të</p>

	<p>Huaja). Referuar RVB cilësia e mësimdhënies rritet nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencës dhe zhvillimit të leksioneve të hapura me personel akademik të ftuar (vullnetarë të Korpusit të Paqes; përfaqësues të ambasadës amerikane; shkëmbimet profesionale me ELTA-n). GVJ konstaton se kjo është pjesërisht e matshme në rezultatet e vlerësimit të parashikuar në Statutin e UE-së (Ref. 1.1 Statuti i UNIEL).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>GVJ konstaton se UE ka miratuar Rregulloren e funksionimit të Komisionit të përhershëm në nivel institucioni për Garantimin e Standarteve të Cilësisë së institucionit dhe Programeve të Studimit në UNIEL, e cila parashikon funksionimin e tij, përgjegjësitë dhe detyrat. Rektori i UE-së nëpërmjet urdhrave të posaçëm, ngarkon strukturat përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e procesit të vlerësimit të cilësisë në UE, të tilla si: Dekanati i njëjësive kryesore, Drejtoria e Kurrikulave dhe SBC, studentë në rolin e anëtarëve të komisioneve të garantimit të cilësisë. (Ref. 6.3 Urdhërat për zhvillimin e pyetësorëve instiucionalë 2021-2022).</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>GVJ evidenton se në DVV është paraqitur një (1) Raport i vlerësimit periodik të mësimdhënies dhe kërkimit shkenco në UE, viti akademik (2021-2022). DGJH, si njësi bazë, është përfshirë në këtë proces nëpërmjet përfaqësueses së një (1) personeli akademik në përbërjen e Komisionit për garantimin e standarteve në Fakultetin e Shkencave Humane. GVJ konstaton se DGJH ka aplikuar pyetësorin për gjurmimin e të punësuarve të diplomuar në DGJH (Ref. 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme në fakultet.pdf. Ref. 5.18 Raport mbi rezultatet e pyetësorit zhvilluar nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja.pdf).</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se UE, i cili mbështetet në Programin e Transparencës UNIEL, ka përfshirë aktorë të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duke respektuar vendimet e Komisionit Institucional të zgjedhjeve për anëtarësinë e Komisionit të Përhershëm të garantimit të standarteve të cilësisë dhe programeve të studimit, duke përfshirë prsonel akademik për çdo department të FSHH, si dhe përfaqësi studentore në përbërje të komisioneve për garantimin e cilësisë (në nivelin instiucional dhe të fakulteteve (Ref.5.7 Vendimi për Komisionin Institucional Zgjedhor.pdf. Ref.5.10 Urdhri për komisionet e përhershme në fakultet.pdf. Ref. 5.12 Miratimi dhe funksionimi i Programit të Transparencës UNIEL.pdf)).</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë</p>	<p>Rereferuar RVB-së, konstatohet nga GVJ se organizimi i aktiviteteve extra kurrikulare, të llojit: trajnime, tryezave të rrumbullakëta, leksione të hapura me personel akademik të ftuar, dëshmojnë përfshirjen në mënyrë të tërthortë të palëve të treta në procesin e përmirësimit të cilësisë së programit të studimit "BA në Gjuhë Angleze" (Ref.1.30 Raporti i fundit periodik analitik i perfitimeve).</p>

lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	nga marreveshjet e bashkepunimit ne funksion te realizimit te programit te studimeve).		
Konkluzione	GVJ konstaton se UE ka miratuar Rregulloren e funksionimit të Komisionit të perhershëm në nivel institucioni për Garantimin e Standarteve të Cilësisë së institucionit dhe Programeve të Studimit në UNIEL, e cila parashikon funksionimin e tij, përgjegjësitë dhe detyrat. Rektori i UE-së, nëpërmjet urdhrave të posaçëm, ngarkon strukturat përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e procesit të vlerësimit të cilësisë në UE, të tilla si: Dekanati dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe SBC. GVJ konstaton se mbështetur në Programin e Transparencës, UNIEL ka përfshirë aktorë të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duke respektuar vendimet e Komisionit Institucional të zgjedhjeve për anëtarësinë e Komisioneve të garantimit të standarteve të cilësisë dhe programeve të studimit në nivel institucional dhe në nivel fakulteti, duke përfshirë personel akademik për çdo departament të FSHH-së, si dhe përfaqësi studentore.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstaton nga vizita në institucion se rezultatet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë i janë përcjellë Rektorit dhe Komisionit të Përhershëm të Garantimit e Standarteve të Cilësisë së institucionit dhe Programeve të Studimit në UNIEL Ref. 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022). (Ref.6.3 Urdhërat për zhvillimin e pyetësorëve instiucionalë 2021-2022).
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ konstaton nga vizita në institucion, konkretisht takimi me Komisionin e Përhershëm të Garantimit e Standarteve të Cilësisë së Programeve të Studimit në FSHH dhe përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë së Brendshme, si dhe referuar dokumentacionit në DVV se rezultatet e raporteve të përpiluara nga DKABC u përcillen Rektorit dhe Komisionit të Përhershëm të Garantimit e Standarteve të Cilësisë së institucionit dhe Programeve të Studimit në UNIEL (Ref.6.3 Urdhërat për zhvillimin e pyetësorëve instiucionalë 2021-2022). Rregullorja e NJSC së UE

	nuk ka parashikur publikimin e rezultateve të raportit të vlerëimit. (Ref. 5.16 Rregullore e NJSC të UE “A.Xhuvani”) . GVJ konstaton se në mbështetje të legjislacionit për të dhënat personale, pyetëtori plotësohet në kushte të anonimatit të plotë. GVJ, në mbështetje të respektit të lirisë dhe etikës akademike, si dhe legjislacionit për të dhënat personale sugjeron që rezultatet individuale të vlerësimit personelit akademik t’u përcillen atyre elektronikisht dhe diskutimi mbi këtë performacë të mos shtohet në mbledhje kolektive.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ konstaton se Raporti mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve, për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në UE, ka dalë me përfundime mbi procesin e vlerësimit tërësor, sipas fakulteteve të përfshira në këtë process dhe nxjer në pah prolematikat dhe mangësitë e procesit të mësimdhënies (Rubrika “Përfundime dhe Rekomandime”), (Ref. 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022) .
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton se Universiteti “Aleksandër Xhuvani” është angazhuar nëpërmjet ndërtimit të kuadrit rregullator të tij, strukturave përgjegjëse për hartimin e politikave për sigurimin e standarteve të cilësisë për programet e studimit, të realizojë procese vetëvlerësimi gjithëpërfshirëse. GVJ konstaton se njësia kryesore, FSHH, nuk ka kryer proces vetëvlerësimi, të kategorizuar sipas programeve të studimit që ky fakultet ofron, por e ka integruar veprimtarinë e tij në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucioni.
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Raporti institucional i vlerësimit thekson nevojën e organizimit të takimeve në çdo fillim viti akademik me qëllim sensibilizimin e studentëve për rëndësinë e përfshirjes së tyre në vlerësimin ndaj institucionit dhe shërbimeve që ai ofron. Takimet parashikohen të asistohen nga DKSBC në bashkëpunim me Njësitë Kryesore dhe Këshillin Studentor (Ref. 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022) . GVJ konstaton se DGJH ka përfshirë studentët e diplomuar në procesin e vlerësimit të programit të studimit (5.18 Raport mbi rezultatet e pyetësorit zhvilluar nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja) .
Konkluzione	<i>GVJ konstaton nga vizita në institucion rezultatet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë i janë përcjellë Rektoratit dhe Komisionit të Përhershëm të Garantimit e Standarteve të Cilësisë së institucionit dhe Programeve të Studimit në UNIEL sipas urdhërave të brendshëm në fuqi. GVJ konstaton se njësia kryesore, FSHH, nuk ka kryer proces vetëvlerësimi, të kategorizuar sipas programeve të studimit që ky fakultet ofron, por e ka integruar veprimtarinë e tij në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucioni. Raporti institucional i vlerësimit hartuar nga DKSBC thekson nevojën e organizimit të takimeve, në çdo fillim viti akademik me qëllim sensibilizimin e studentëve për rëndësinë e përfshirjes së tyre në vlerësimin ndaj institucionit dhe shërbimeve që ai ofron.</i>
Shkalla e përmbushjes së	Përmbushet Përmbushet Përmbushet

standardit		plotësisht	kryesisht	plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë Angleze” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Xhuvani”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Universiteti “Aleksandër Xhuvani” demonstroi se ka maksimalisht përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, pasi ky institucion është certifikuar nga Bordi i Akreditimit për akreditimin institucional me vlerësimin maksimal për gjashtë (6) vite.
2. Personeli akademik efektiv i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, përmbush detyrimet dhe tejkalon parashikimin ligjor mbi titujt dhe gradat shkencore, si kusht për mësimdhënie në këtë cikël studimi.
3. Mobiliteti i vazhdueshëm dhe i lartë i personelit akademik të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” në institucione të huaja për qëllime trajnimi dhe mësimdhënieje, si dhe aktivizimi i lektorëve të huaj të pranishëm në këtë program studimi, janë tregues domethënës për ndërkombëtarizimin e këtij programi studimi.
4. Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” ofrohet me një kurrikul bashkëkohore, e cila është e ngjajshme me kurrikula të programeve analoge në IAL të huaja dhe siguron njohjen e krediteve të lëndëve të frekuentuara përgjatë procesit të mobilitetit të studentëve hyrës dhe dalës në këtë program studimi.
5. Përfshirja e studentëve në strukturat për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucioni dhe fakulteti garanton transparencën dhe standartet në procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë.
6. Vënia në dispozicion dhe funksionimi i plotë dhe efikas i sistemit digjital për menaxhimin e sekretarisë mësimore dhe lehtësimin e procedurave të ruajtjes, administrimit dhe shpërndarjes së të dhënave dhe informacionit.
7. Infrastruktura mësimdhënëse dhe përdorimi i teknologjisë digjitale në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” janë në nivele të përparura.
8. Mirë funksionimi i kuadrit rregullator të brendshëm për drejtimin e strukturave akademike dhe ndihmës akademike ka rritur cilësinë e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”.

Pika të dobëta:

1. Forma e Diplomës në përfundim të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, ofruar nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave

Humane, Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, është regjistruar në "Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor", me emërtimin "Diplomë e Nivelit të Parë", e cila nuk është në përputhje me Udhëzimin MASR, Nr. 10, datë 30.03.2020, për regjistrimin e formës së Diplomës në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), (Standarti I.1/Kriteri 5).

2. GVJ konstaton mungesën e një strategjie institucionale të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë sipas VKM 824, 24.12.2021, "Miratimi i Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë". Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë në Fakultetin e Shkencave Humane" nuk funksionon konform Udhëzimit të MASR, Nr. 27, dt.29.12.2017: "Për strukturat e brendshme akademike, ndihmës akademike dhe administrative në IAL-të publike", pasi fusha e veprimtarisë së tij në Fakultetin e Shkencave Humane nuk mbështetet në një rregullore të posaçme dhe sigurimi i brendshëm i cilësisë është i kufizuar në bërjen e politikave, hartimin e udhëzuesve dhe mekanizmave të monitorimit të cilësisë për programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze", për të cilin nuk ka raporte të posaçme të sigurimit të cilësisë (Standarti VI.1/ Kriteri 2; Standarti VI.2/ Kriteri 2/4 ; Standarti VI.3/ Kriteri 2/4).
3. Një pjesë e konsiderueshme e literaturës së detyrueshme/bazë në sylabuset e lëndëve nuk është e përditësuar me botime të dekadës së fundit. (Standardi IV.3, kriteri 2).
4. Praktika profesionale nuk është përfshirë si veprimtari brenda kuadrit të lëndëve të kategorisë D duke mos përmbushur detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, VKM nr. 41, datë 24.01.2018 për "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL". (Standardi II.I, kriteri 4).
5. Numri shumë i ulët i studentëve të regjistruar në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze".

Rekomandime

1. Universiteti "Aleksandër Xhuvani", duhet të regjistrojë formën e diplomës Bachelor në "Gjuhë Angleze" në "Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor" në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA) sipas Udhëzimit MASR, Nr. 10, datë 30.03.2020, për regjistrimin e formës së Diplomës.
2. Universiteti "Aleksandër Xhuvani", duhet të ndërtojë një strategji institucionale për monitorimin e cilësisë së programeve të studimit që ofron, e cila parashikon hartimin dhe zbatimin e politikave të sigurimit të brendshëm të cilësisë, ndërtimin e disa

instrumentave të standartizuar matës të cilësisë, si dhe të realizojë raportimin e rezultateve të cilësisë për çdo program studimi, përfshirë Programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze". Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë duhet të veprojë në nivel njësie kryesore (Fakulteti i Shkencave Humane) për të kryer procesin e plotë të vlerësimit të brendshëm të cilësisë për çdo program studimi që ofron FSHH, përfshirë Programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze".

3. Literatura e detyrueshme/bazë në sylabuset e lëndëve duhet të përditësohet me botime të dekadës së fundit.
4. Praktika profesionale duhet përfshirë si veprimtari brenda kuadrit të lëndëve të kategorisë D duke përbushur detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë, VKM nr. 41, datë 24.01.2018 për "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL".
5. Institucioni duhet të marrë masa konkrete të menjëhershme për të ndërtuar dhe përdorur mekanizma të posaçëm për të rritur numrin e të regjistruarve në këtë program studimi të tilla si: studimi i tregut të punës të studentëve të diplomuar në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" dhe promovimi i vazhdueshëm i programit të studimit.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "English Language" provided by the Higher Education Institution "University Aleksandër Xhuvani"

Strengths and affirmations

1. "Aleksandër Xhuvani" University demonstrates that it has the utmost experience, abundant capacities and appropriate resources for offering Bachelor study program in "English Language", as this institution has been certified by the Accreditation Board for institutional accreditation with the maximum rating of six (6) years.
2. The effective academic staff engaged in the Bachelor study program in "English Language", fulfills the obligations and exceeds the legal provision in Albanian law for higher education on scientific titles and degrees, as a condition for lecturing in this cycle of study.
3. The continuous mobility of the academic staff of the Bachelor study program in "English Language" in foreign institutions for training and lecturing purposes, as well as the activation of foreign lecturers present in this study program, are significant indicators for the internationalization of the Bachelor study program in "English Language" offered by "Aleksandër Xhuvani" University.

4. The Bachelor's study program in "English Language" is offered with a contemporary curriculum, which is similar to the curricula of similar programs in foreign HEIs and ensures the recognition of the credits of courses attended during the mobility process of incoming and outgoing students in this program the study.
5. Inclusion of students in quality assurance and monitoring structures at the institution and faculty level guarantees the transparency for the standards of internal quality assurance of this study program.
6. The provision of a full option and efficient operation digital system for the management of the teaching and secretariat activity providing the facilitation of the procedures of storage, administration and distribution of data and information.
7. The teaching infrastructure and the use of digital technology in the implementation of the Bachelor study program in "English Language" are at advanced levels.
8. The optimal functioning of the institution internal regulatory framework for the management of academic and academic assistance structures in the institution has increased the quality of the Bachelor study program in "English Language".

Weaknesses

1. The registration of the Diploma Form of the Bachelor's study program in "English Language", offered by the Department of Foreign Languages, Faculty of Human Sciences, "Aleksandër Xhuvani" University, Elbasan in the "State Register of Diplomas and Certificates for Higher Education and Scientific Research", as "First Level University Degree" does not fulfill the obligations of the Ministry of Education, Youth and Sports Decision, No. 10, date 30.03.2020, for the registration of the Diploma form at the Center for Educational Services. (Standard I.1/Criterion 5).
2. The lack of an institutional strategy of the Internal Quality Assurance System for quality improvement which would have been drafted under the provisions of the Council of Ministers decision nr. 824, 24.12.2021, "Approval of the Quality Code of Higher Education". The Permanent Commission on Quality Assurance in the "Faculty of Human Sciences" does not operate in accordance with the The Council of Ministers Decision, No. 27, 29.12.2017, "On the internal academic and administrative structures in public HEIs", since this structure's operation is very limited in relation to quality assurance policy making and drafting guidelines. EQA experts notice the lack of specific quality assurance reports for the respective Bachelor's study program in "English Language". (Standard VI.1, Criterion 2, Standard IV.2 Criterion 2/4, Standard IV.3, Criterion 2/4)
3. A significant part of the required literature in the course syllabi of the Bachelor study program in "English Language" is not updated with recent publications of the last decade. The online library resources provided by UE are not recommended as well. (Standard IV.3-Criterion 2)

4. Professional practice is not included as an activity within the framework of category D subjects, not meeting the requirements provided in The Council of Ministers Decision No. 41, date 24.01.2018 on "Elements of study programs offered by HEIs".(Standard II.I, Criterion 4).
5. The decreasing and a very low number of students enrolled in Bachelor study program in "English Language".

Recommendations

1. EQA experts recommend that the institution of Higher Education, University "Aleksandër Xhuvani" should register the Diploma Form of the Bachelor study program in "English Language", in the "State Register of Diplomas and Certificates for Higher Education and Scientific Research" at the Center for Educational Services, according to the the Ministry of Education, Youth and Sports Decision, No. 10, date 30.03.2020, for the registration of the Diploma form.
2. The institution should compile a strategic plan with the scope of monitoring the quality of each study programs it offers. This plan should comprise the implementation of internal quality assurance policies, the design of several standardized quality measuring instruments and the reporting of quality results and recommendations for every study program, including the Bachelor study program in "English Language". The Internal Quality Assurance Unit must operate at the faculty level in order to carry out the full internal quality assessment process for every study program it offers including the Bachelor study program in "English Language".
3. EQA experts recommend that the study program syllabi literature section should be updated with the publications of the last ten years according to the typology of the subject. The possibility of recommending electronic sources of literature such as online libraries offered by the institution should also be taken into account.
4. EQA experts recommend the inclusion of the professional practice in the curriculum, with the aim of meeting the requirements provided in The Council of Ministers decision no. 41, date 24.01.2018 on "Elements of study programs offered by HEIs"
5. The institution should take immediate efficient measures and exploit relevant possibilities to increase the number the students enrolled in this study program such as the study of the labor market and the intense, constant promotion of the study program.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
			Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHITETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X

